



2019

RAPORTI VJETOR

abi AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

RAPORTI VJETOR 2019

4

Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

6

Qeverisja e Korporatës

8

Struktura Organizative

10

Burimet Njerëzore

14

Ecuria dhe Treguesit Kryesor

16

Njësia e Operacioneve

18

Njësia e Kredisë

20

Njësia Bankare Retail

22

Përgjegjësia Sociale

34

Rrjeti i Degëve dhe ATM

36

Pasqyrat Financiare 2019 / Raporti i Auditorit të Pavarur

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

ABI Bank tashmë është jo vetëm një fillim inkurajues por një destinacion për punonjësit dhe klientët më të mirë në treg.

“Moti i mirë duket që në mëngjes” i përshtatet shumë historisë së ABI-t. Rezultatet rekord gjatë vitit 2019 janë fryt i një pune të filluar vite përpara. Viti 2019 raporton një rekord fitimesh neto prej mbi EUR 6 milionë dhe për më shumë një pozicionim afatgjatë të ABI Bank si një pjesëtare e konfirmuar dhe e konsoliduar në treg.

ABI Bank tashmë është jo vetëm një fillim inkurajues por një destinacion për punonjësit dhe klientët më të mirë në treg. ABI sjell në tregun bankar vlera që mishërojnë më së miri sinergjinë e dy kulturave, Amerikane dhe Shqiptare. Shumë prej punonjësve apo klientëve të ABI-t u jepet mundësia të rikrijojnë, apo ristrukturojnë jetën e tyre profesionale dhe biznesin e tyre.

Kultura e të punuarit dhe e të bërit biznes te ABI është e thjeshtë, e qartë, dhe e drejtpërdrejtë. Nuk ka asnjë marrëdhënie apo transaksion me punonjës apo klientë që është më i rëndësishëm se sa reputacioni ynë në treg. Ne duam të njihemi si banka me më integritet, më pozitive, më e përkushtuar dhe më profesioniste në tregun bankar. Cilësia e punonjësve dhe e klientëve që na janë bashkuar në kohë dëshmon se ABI është në rrugën e duhur.

ABI gjatë vitit 2019 u fokusua në përfundimin e bashkimit të dy bankave. Me shumë sukses u përfundua në kohë rekord transformimi i bashkimit të dy teknologjive. Zgjidhjet teknologjike janë bashkëkohore dhe me sisteme të avancuara. Për më shumë këto sisteme janë vendosur në ambiente krejtësisht të reja me masat e duhura mbrojtëse dhe mbështetëse.

Gjatë gjithë vitit 2019, u kujdesëm të ndryshonim ambientet e punës në zyrat qendrore dhe në shumicën e degëve të bashkuara. Sot ambientet e punës së kolegëve, zyrat e pritjes së klientëve, ambientet e konferencave, dhe ambientet ndihmëse janë të një cilësie dinjitoze për çdo bankë Europiane apo Amerikane. Veçojmë këtu cilësinë e ambienteve hyrëse të zyrave qendrore, ambientet e kredisë korporative, marrëdhëniet e Retail, degës së ABI-t në zonën e ish-Bllokut që është dega me sipërfaqen më të madhe në Shqipëri. Mesazhi dhe e vërteta jonë e

thjeshtë është që punonjësit dhe klientët e ABI-t meritojnë ambientet më cilësore.

Nga ana operacionale është synuar që të krijohet një bashkëpunim midis departamenteve të korporatave dhe retail me të gjitha degët. Kjo do të sigurojë një shërbim 360 gradë në të gjithë degët ABI. Një ngjarje e rëndësishme është dhe krijimi i departamentit të kredidhënies imobiliare (hipotekare) brenda degës së ABI-t në zonën e ish-Bllokut.

Situata me tepriçë kapitali dhe likuiditeti ka mundësuar një përjasje të matur në vendimarrjen e kredidhënies. Viti 2019 ishte një vit rekord me mbi EUR 50 milionë kredi të reja. Kjo ka mundësuar daljen e ABI-t nga marrëdhënie që ndonëse fitimprurëse nuk përputhen me kulturën kredidhënëse të ABI-t. Përqëndrimi në shërbimin butik për kreditë korporative, të mesme dhe retail do të vazhdojë të jetë përparësi e jona. Autenticiteti është ngjites dhe mbresëlënës dhe ne duam të jemi autentik në biznesin tonë butik. Sidomos në kredidhënien e korporatave dhe kompanive të mesme, ne kemi një përjasje shumë të personalizuar dhe afatgjatë. Fushata e kredidhënies për shtëpi mundësoi njohjen e ABI-t për herë të parë në tregun bankar si alternativa më e favorshme për klientët. Klientët mund të gjejnë çdo produkt të ABI, të personalizuar sipas nevojave të tyre.

Gjatë 2019, ulja e kredive të këqija nga EUR 40 milionë në EUR 32 milionë, pra mbi 20%, ka vazhduar të jetë një objektivi i rëndësishëm te ABI. Treguesi i Kredive me Probleme u ul në nivelin 15.4% për dhjetorin 2019 krahasuar me 19.5% të një viti më parë. Kjo ulje domethënëse është rezultat i bashkëpunimit të ABI me Tranzit që tashmë ka krijuar një dinamikë të pakrahasueshme në tregun bankar shqiptar. Pritshmëria për vitin 2020 është për një ulje në nivele një shifrore të kredive të këqija. Brenda vitit 2021, ABI planifikon të ketë nivelin më të ulët të kredive të këqija (njësoj si në vitin 2017).

ABI vazhdon të jetë e interesuar për tërheqjen e talenteve më të mira të sistemit bankar. Ne mendojmë se mundësitë

te ABI krijojnë premisa afatgjata për rritjen profesionale, kulturore, dhe financiare. Objektivi ynë është të kemi ekipin më të mirë në shërbim, drejtim dhe kredidhënie.

ABI e shikon aktivitetin e saj në përputhje të plotë të interesave të komuniteteve ku shërben. Dhe gjatë vitit 2019, ABI raporton mbështetje rekord të aktiviteteve kulturore, sportive, mbështetëse për komunitetet në nevojë, apo programacioneve që përfaqësojnë denjësisht vlerat më të mira të vendit tonë. Motoja jonë “Investo në Optimizëm” do të vazhdojë të jetë në themel të çdo ndërmarrjeje kulturore apo financiare. Pavarësisht nga sfidat dhe vështirësitë e shumta të komuniteteve dhe bizneseve në vend, ne duam të sjellim në vëmendje dhe të mbështesim ato ndodhi, përpjekje, individë, apo iniciativa që sfidojnë paragjykimet dhe pengesat e gjithëpranuara prej kohësh.

Është shumë më e vështirë dhe më pak në modë të jesh një optimist i saktë, se sa një pesimist i gabuar. Ne do të vazhdojmë të mbështesim optimizmin e saktë në Shqipëri. Disa nga aktivitetet më domethënëse në këtë drejtim kanë qenë mbështetja e ciklit të podcast “Shqiptarët e Mrekullueshëm” me gazetaren e mirënjohur Rudina Xhunga, apo “Hostel” me krijuesen Dalina Buzi. Të dyja këto profesioniste sjellin një realitet të ri, të kultivuar dhe optimist ku përshtypja e mirë për vendin tonë dukshëm fillon nga respekti dhe vlerësimi ynë për veten.

Sfidat e ABI për 2020 lidhen kryesisht me konsolidimin e mendësisë të të qenurit më të mirët në treg. Akoma kemi nevojë të kuptojmë se potenciali ynë më i madh është liria që kemi për të rikrijuar veten nga e para mbi themele tashmë shumë të shëndetshme dhe të mirësprovuara. “The best way to predict your future is to create it/Mënyra më e mirë për të parashikuar të ardhmen është ta krijosh atë” është një e vërtetë e thjeshtë e Abraham Lincoln.

ABI do të vazhdojë të krijojë të ardhmen e duhur për vete dhe klientët e saj .

ANDI BALLTA
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

QEVERISJA E KORPORATËS

Banka Amerikane e Investimeve SHA ka miratuar Kodin e Qeverisjes së Korporatës i cili është në përputhje me Statutin e Bankës dhe legjislacionin në fuqi. Kjo rregullore përfshin rregullat e brendshme të Bankës, parimet dhe mekanizmat e kontrollit në bazë të të cilave Banka organizohet dhe menaxhohet, duke miratuar një strukturë e cila është transparente për investitorët, duke njohur dhe respektuar të drejtat e personave të cilët ndikohen nga aktiviteti bankar dhe duke siguruar interesat legjitime të aksionarit të vetëm të Bankës. Principet bazë të Kodit të Bankës mbi Qeverisjen e Korporatës përshkruhen në vijim:

KËSHILLI DREJTUES¹:

KATHRYN SWINTEK

Kryetare e Këshillit Drejtues
(anëtare e pavarur)

ROBERTO MUNOZ

Anëtar i Këshillit Drejtues
(anëtar i pavarur)

ERNST SCHLAUCH

Anëtar i Këshillit Drejtues
(anëtar i pavarur)

KRISTIN GIANTRIS

Anëtare e Këshillit Drejtues
(anëtare e pavarur)

ARMAND MUHARREMI

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor i Divizionit të Financës)

ANDI BALLTA

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor Ekzekutiv i Përgjithshëm)

BRUNILDA PAPA

Anëtare e Këshillit Drejtues
(Drejtore e Njesisë së Operacioneve)

Të drejtat e aksionarit

Banka ka vendosur rregulla që garantojnë për aksionarin, marrjen e informacionit të plotë mbi kushtet financiare të Bankës, si dhe mbi vendimet e Menaxhimit që ndikojnë ndjeshëm në veprimtarinë e saj

Përbërja e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë ekzekutivë dhe jo ekzekutivë (të pavarur), në përputhje me kërkesat e Ligjit për Bankat në Shqipëri. Diversiteti në arsim, përvojë dhe në fushat e ekspertizës së anëtarëve të Këshillit Drejtues është një faktor kyç në drejtimin e një banke Boutique.

Detyrat e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues, është një organ vendimmarrës, i cili i përgjigjet drejtpërdrejt aksionarit të vetëm. Këshilli Drejtues në përputhje me Statutin e Bankës dhe Kodin

e Qeverisjes së Korporatave përcakton vizionin, misionin dhe strategjinë e Bankës. Qëllimi kryesor i Këshillit Drejtues është të sigurojë veprimtari të shëndetshme të kompanisë, duke ndjekur rritjen afatgjatë të vlerës ekonomike të saj, duke monitoruar, drejtuar dhe kontrolluar ekzekutivin në përputhje me interesat e Aksionarit.

Kontrolli i Brendshëm

Banka ka një divizion të organizuar të Kontrollit të Brendshëm, i mbikëqyrur nga Komiteti i Kontrollit të Bankës. Ky i fundit, në përputhje me kërkesat ligjore, përbëhet nga tre anëtarë të pavarur, ekspertiza dhe monitorimi i të cilëve është një ndihmë e vlefshme dhe e vazhdueshme për Bankën. Kryetari i Komitetit të Kontrollit është njëkohësisht anëtar i Këshillit Drejtues.

¹ 22 Tetor 2019; Mark Crawford largohet si anëtar i Këshillit Drejtues dhe Brunilda Papa emërohet anëtare e re e Këshillit Drejtues.

KËSHILLI DREJTUES

KOMITETI I AUDITIT

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
EKZEKUTIV


DIVIZIONI I AUDITIT
TE BRENDSHËM

KËSHILLTAR TË ZYRËS CEO

DEPARTAMENTI I
PËRPUTSHMËRISË DHE AML

EKSPERIENCA E KLIENITIT
DHE MENAXHIMI I CILËSISË

SEKTORI I PËRGJEGJËSISË SOCIALE



STRUKTURA ORGANIZATIVE



BURIMET NJERËZORE

PUNONJËSIT JANË SHUMË TË RËNDËSISHËM...

Në ABI Bank, prioritet dhe element kyç i suksesit dhe në fokus të menaxhimit, janë punonjësit, mbështetja, trajnimi, zhvillimi dhe vlerësimi i tyre. Si gjithmonë, stafi vazhdon të jetë pika jonë më e fortë.

Vetë qëllimi i punës në Divizionin e Burimeve Njerëzore është krijimi dhe ruajtja e një ambienti pune tërheqës dhe profesionalisht stimulues.

Gjatë vitit 2019, punonjësit tanë janë karakterizuar nga aftësi dhe përpjekje të forta për të përmbushur standardet dhe objektivat e përcaktuara si dhe për të realizuar në kohë e me sukses strategjinë e Bankës.

Një rëndësi të veçantë për punonjësit e ABI Bank, për vitin 2019 ka pasur Procesi i Vlerësimit të Performancës, i cili u implementua për herë të parë për të gjithë bankën e bashkuar sipas metodologjisë së përdorur nga ABI. Ky është një proces shumë transparent, me në fokus vlerësimin e punonjësve në planin 360°, i cili garanton një vlerësim performance shumë efektiv dhe eficient.

Gjithashtu, politikat e bankës për punësim dhe trajtim në mënyrë të barabartë, i ka mundësuar 49 punonjësve të gjejnë punë afatgjatë apo afatshkurtër, brenda institucionit tonë, duke siguruar procese rekrutimi të suksesshme dhe cilësore.

2 PROCESI I KONSOLIDIMIT DHE APROVIMI I STRUKTURËS NË ABI

Gjatë vitit që lamë pas, fjalët "konsolidim", "integrim", "optimizëm" u bënë pjesë e fjalorit tonë të përditshëm duke na sjellë më afër institucionit dhe kulturës që synojmë.

Në ABI çdo punonjës, mund të krijojë tashmë, profilin e tij si vlerë të shtuar mbi vlerën e konsoliduar.

Një nga proceset më impenjative të vitit që lamë pas, ishte dizenjimi dhe implementimi me sukses i Strukturës Organizative të Bankës, të miratuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues në muajin Prill 2019, e që solli procesin e bashkimit të Degëve, ku disa departamente u angazhuan njëkohësisht në bashkëpunim të plotë, për realizimin me sukses të këtij procesi. Bashkimi jo vetëm fizik i degëve, konsistoi në menaxhimin sa më efektiv të burimeve njerëzore të stafit të rrjetit të degëve. Gjithashtu, në kuadër të Strukturës Organizative u hartua, miratua dhe implementua Struktura e Pagave për bankën e bashkuar duke rikonfiguruar sistemin e gradave për të gjithë punonjësit e ABI-t.

Trajnimet e zhvilluara, të brendshme apo të jashtme, qoftë për sistemin ashtu si edhe workshop-et e organizuara me qëllim ndarjen dhe shkëmbimin e eksperiencave pas momentit të transformimit, rezultatet e arritura, pritshmëritë e gjithsecilit sipas këndvështrimeve respektive, në vijim të të cilëve u zhvillua pyetësori "Team Barometer" me qëllim ndarjen e eksperiencave të ndryshme dhe gjetjen e pikave të përbashkëta pas procesit të bashkimit, si në nivel banke ashtu edhe në nivel ekipesh brenda bankës.

Një tjetër proces i rëndësishëm dhe impenjativ, ishte trajnimi i stafit në sistemin Flexcube, ku BNJ siguruan dhe ndoqën mbarëvajtjen e këtij procesi për një periudhë disa javore.

Në kuadër të krijimit të një fryme bashkëpunimi e kulture të përbashkët, janë organizuar me sukses festat, të kthyer në kulturë tashmë në ABI, si Dita e 8 Marsit, Takimi Vjetor i Falenderimit të Klientëve, Festa e Fëmijëve, Festa e 4 Korrikut, Halloween, Festat e fundvitit për stafin dhe fëmijët etj.

3 RESPEKTIMI I DIVERSITETIT

Banka Amerikane e Investimeve i jep mundësi të barabarta të gjithë kandidatëve dhe punonjësve pavarësisht nga mosha, gjinia, gjendja martesore, shtatzënia, statusi familjar, aftësia e kufizuar, raca, kombësia ose feja.

Divizioni i Burimeve Njerëzore, brenda fushës së tij të veprimit dhe kontrollit, garanton një angazhim maksimal në trajtimin në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të individëve duke mos lejuar diskriminimin në asnjë moment gjatë të gjitha fazave të punësimit në ABI.

4 TË DHËNAT SIPAS GJINISË

Banka Amerikane e Investimeve është një ndër të vetmet banka në sistemin bankar, bordin e së cilës e drejton një anëtare femër.

Gjithashtu, koleget femra përbëjnë 69% të forcës punëtore të ABI Bank dhe 55% përsa i takon linjës së parë të menaxhimit.

ECURIA DHE TREGUESIT KRYESORË

TË DHËNA FINANCIARE

Viti 2019 u karakterizua nga një fokus i shtuar në konsolidimin operacional si dhe optimizimin e rrjetit të degëve të bankës, në vijim të blerjes dhe përthithjes, gjatë gjysmës së 2-të të vitit 2018, të ish-Bankës Kombëtare të Greqisë në Shqipëri. Paralelisht, rrethanat e tregut, optimizimi i burimeve njerëzore si dhe bashkimi i klientëve e portofoleve likuiditete-kredi-depozita çuan në rritjen e mëtejshme të aktiviteteve të investimeve dhe kredidhënies si dhe përmirësimin e ndjeshëm të treguesve të përfitueshmërisë. Kështu, ABI për vitin 2019, shënoi rezultatin më të mirë në histori duke raportuar fitim neto para taksave në nivelin prej EUR 8 milionë.

Në të njëjtën kohë, Banka shënoi një rritje prej 1.5% (afërsisht EUR 10mln) të totalit të aktiveve që i atribuohet kryesisht rritjes së depozitave të klientëve. Portofoli i kredisë neto raportoi rritje prej 1.5% ndërsa investimet në letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare raportuan rritje prej 10% krahasuar me mbylljen e vitit 2018.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK) dhe Norma e Likuiditetit më 31 dhjetor 2019 raportojnë perkatësisht mbi 20% dhe mbi 80% duke përfaqësuar një nga nivelet më të larta të kapitalizimit dhe absolutisht normën më të lartë të likuiditetit në sistemin bankar.

Indikatorët kryesorë	2019 (EUR milionë)	vs. 2018
Aktivet totale	639	↑ +1.5%
Depozita totale	534	↑ +0.5%
Kredia neto	204	↑ +1.5%
Investimet në Letra me vlerë	261	↑ +10%
Kapitali	79	↑ +3.5%
Fitimi neto para taksave	8	↑ +45%
Renditja sipas aseteve totale	Nr. 7	e pa-ndryshuar
Renditje sipas equity	Nr. 5	e pa-ndryshuar

NJËSIA E OPERACIONEVE

Në përditshmërinë e saj, Njësia e Operacioneve e përbërë nga Divizioni IT, Divizioni i Operacioneve Bankare, Divizioni i BPO, Divizioni i Administratës dhe Departamentet e tjera të Njesisë së Operacioneve punojnë në një ambient të kontrolluar dhe risk të disiplinuar për të siguruar cilësi të shkëlqyer të performancës së produktit, mbrojtjes së sistemeve bankare dhe ruajtjes së të dhënave të klientit. Siguria, përsosmëria operationale dhe besimi në konceptin e Bankës sonë butik janë kërkesë bazë të çdo operacioni Bankar.

Njësia e Operacioneve si lider i ri-inxhinjerimit të proceseve bankare, vlerëson rezultatin e tipologjisë së kontrollove të bankës për të përcaktuar nëse kërkojnë ndërhyrje specifike për ndryshim e përmirësim. Rishikimi i proceseve gjatë 2019, ka synuar sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së proceseve ka adresuar çështje të riskut operacional, duke u përqëndruar në përmirësimin e efikasitetit dhe kontrollove të disa proceseve si dhe mbikqyrja e kontrollove të përmirësuar.

Në konceptin e Bankës sonë butik, klientët janë qendra absolute e gjithçka ne bëjmë dhe çdo ditë ne përpiqemi t'iu japim këshilla të diferencuara dhe zgjidhje të përshtatura për ta. Ne shikojmë rregullisht produktet dhe shërbimet që i ofrojmë klientëve dhe kërkojmë mënyra për të forcuar besnikërinë e klientit në gjithë gamën e produkteve. Ne jemi përqëndruar në:

- Rritjen e lehtësisë për të udhëzuar dhe drejtuar klientët në përdorimin e gjithë gamës së produkteve dhe shërbimeve nëpërmjet rrjetit të degëve të rikonstruara; dhe
- Rivlerësimin e produkteve dhe shërbimeve aktuale për të përmirësuar dobishmërinë dhe karakteristikat e tyre, duke u fokusuar në teknika më të forta monitorimi për të dhënë përvojë të qetë e të sigurtë për klientët tanë.

Në kuadër të planit të përgjithshëm të bashkimit të ABI Bank me ish bankën NBG Albania, objektivi dhe aktiviteti kryesor i Divizionit IT ishte implementimi i suksesshëm i Planit të Shkëputjes dakordësuar, me Grupin NBG, brenda afateve shumë strikte të përcaktuara. Ky plan përfshinte gjithë infrastrukturën dhe sistemet IT, por sfida kryesore ishte Migrimi i të dhënave të sistemit qendror bankar të ish NBG Albania në sistemin bankar të ABI-t (CBS). Projekt tjetër i rëndësishëm ishte ndërtimi i "Data Center" të ri në ambientet e Drejtorisë së

Përgjithshme të Bankës, një investim i rëndësishëm dhe modern, që siguroi kapacitete hostuese të paktën të dyfishuara. Pas bashkimit të suksesshëm të sistemeve të IT, edhe përgjatë 2019, banka nisi 2 projekte të tjera të rëndësishme, Ndryshimin e Procesorit dhe Personalizuesit të Kartave dhe faza përgatitore për implementimin e versionit të ri të Sistemit Qendror Bankar (Flexcube).

Migrimi i të dhënave të Sistemit Qendror Bankar, projekti më i rëndësishëm dhe kompleks u përfundua në mënyrë të suksesshme më 1 Maj 2019, duke ruajtur integritetin, disponueshmërinë dhe performancën e sistemit dhe të dhënave. Me mbështetjen e madhe të menaxhimit të ABI-t, projekti u realizuar në linjë me bashkimin ligjor të bankës dhe unifikimin e produkteve dhe shërbimeve bankare. Projekti u implementua me përfshirjen e të gjithë njësive të biznesit, të cilat dhanë mbështetjen e plotë për një migrim të suksesshëm të të gjithë komponentëve, si dhe mirëmbajtjen e mëposhme.

Ndërtimi i "Data Center" të ri erdhi jo vetëm si një kërkesë për rritje të kapaciteteve si rrjedhojë e bashkimit për akomodimin e sistemeve dhe të dhënave të trashëguara nga ish Banka NBG Albania, por gjithashtu me vizionin për të rikonstruuar dhe modernizuar të gjithë ambientet e punës në Drejtorinë e Përgjithshme ABI. "Data Center" i ri është ndërtuar për të siguruar disponueshmëri të lartë (redundance të plotë), duke aplikuar dizajn dhe teknologjinë më të fundit, me hapësira të dedikuara për infrastrukturën e telekomit, elektrike dhe për dhomën e servereve, me arkitekturë ishull.

Menjëherë pas përfundimit të bashkimit të CBS nisi një tjetër projekt, Ndryshimi i Personalizimit dhe Procesorit të Kartave nga partneri aktual. Ky ndryshim synon të sigurojë shërbime dhe produkte më të mira për klientët, më të shpejta e më efikente. Ky ndryshim u shoqërua me zhvillime të rëndësishme për produktet dhe shërbimet përkatëse në Sistemin Qendror Bankar.

Një vendim i rëndësishëm menjëherë pas bashkimit të sistemeve IT ishte lidhur me përgatitjen për projektin madhor të implementimit të versionit të ri të sistemit Qendror Bankar- Flexcube nga version aktual 10.2 në versionin 14.3. Për këtë qëllim, gjatë vjeshtë-dimër 2019 u përfundua marrëveshja e migrimit të Licensave në versionin e ri me Oracle, u organizua procesi i tenderimit të shërbimeve të Upgrade-it

si dhe u bë vlerësimi i propozimeve teknike dhe financiare.

Objektivi i Divizionit të Operacioneve Bankare në migrimin e të dhënave të Sistemit Qendror Bankar ishte operimi pa probleme/ ndërprerje në shërbimet e pagesave, dhe minimizimi i kostove në bashkimin e dy Bankave, në veçanti operimi pa problem me sistemet e pagesave pranë Bankës së Shqipërisë dhe infrastrukturën e Swift për periudhën para dhe pas bashkimit, bashkëpunimi me institucionet buxhetore. Me sukses, në kohë, dhe me minimum kostosh u realizua transferimi i licensave të pjesëmarrjes së Swift, dhe në skemën e pagesave VISA. Në migrim u arrit me sukses minimizimi i dyfishimit të klientëve në Sistemin Qendror Bankar (efekt në ulje kostosh); migrimi i Kartave të Debitit dhe Kreditit, migrimi i produkteve të Financës Tregtare, operimi dhe bashkëpunimi me rrjetin e Bankave Korrespondente.

Operimi i suksesshëm, korrekt, i sigurt e pa probleme në migrim dhe post migrim i bankës së bashkuar, me gjithë partnerët dhe sistemet interface, vijon të jetë objektivi ynë i përditshëm.

Objektiv shumë i rëndësishëm i drejtuesve të njësive operationale ishte trajnimi i stafit të degëve gjatë periudhës përgatitore para migrimit, si dhe në trajnimet e tjera të 2019 që synonin unifikimin e persiatjes në shërbim dhe në procese pune, të stafit të rrjetit të degëve.

Viti 2019, ishte viti kur projektet e Bankës Amerikane të Investimeve për një vend dinjitoz mes simotrave në industrinë bankare në vend, u formësua përmes investimeve të kryera edhe në drejtim të përmirësimit të ambienteve të punës për stafin dhe atyre pritëse për klientët tanë.

Investimi total prej rreth 2 mil Eur, mundësoi rikonstrukcionin e ambienteve të degëve të Bankës dhe të zyrave qendrore në ABI Tower, të konceptuara tashme në kushte optimale. Investimet përfshijnë rikonceptim dhe përmirësim të ambienteve dhe aspektin ndërtimor, të sistemeve të kondicionimit, ashensorëve, ndërtimin e një "Data Center" të ri, modern, dhe krijimit të ambienteve të tjera multifunksionale dhe cilësore për stafin.

Gjatë këtij viti u rikonstruktuan në mënyrë të pjesëshme dhe të plotë mbi 10 degë, si dhe përfunduan punimet në zyrat qendrore, të cilat tashmë, përveç hapësirave të bollshme, komode dhe bashkëkohore, ofrojnë për stafin dhe ambiente sportive dhe të rekreacionit.



NJËSIA E KREDISË

ABI Bank konfirmoi pozicionin e saj në treg edhe për vitin 2019 si një ndër bankat që vijon me rritje në sektorin bankar në Shqipëri. ABI Bank krenohet me të qenurit një Bankë butik e fokusuar në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët dhe ofrimin e mbështjetjes financiare me qëllim përmbushjen e kërkesave të veçanta të klientëve. Me një mentalitet të fokusuar tek klientët, ne po bëhemi gjithmonë e më tepër një partner i besueshëm dhe burim kryesor dhe i rëndësishëm i kapitalit për bizneset (shoqëritë e mëdha, të mesme e të vogla) në sektorin publik e privat në vend, duke ofruar një sërë produktesh dhe shërbimesh nga kredi afatshkurtra për kapital qarkullues deri në kredi afatgjata për investime.

Të qenurit një Bankë butik i jep mundësi ABI Bank të jetë shumë pranë interesave dhe nevojave të veçanta të klientëve. Fokusi ynë tek klientët dhe përparësia që i japim klientëve, ka mundësuar që ABI Bank të përfaqësojë pothuajse 5% të tregut të kredive për vitin 2019. Ne kemi vazhduar të mirëmbajmë marrëdhëniet tona ekzistuese me klientët dhe për më tepër kemi zgjeruar bazën e klientëve tanë duke mbështetur dhe financuar dhjetra klientë të rinj në vitin 2019.

Ne monitorojmë me kujdes zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe analizojmë me detaje rritjen e disa sektorëve të veçantë në ekonomi në mënyrë që t'i shërbejmë nevojave gjithnjë të ndryshueshme të

klientëve në këto sektorë.

Gjatë vitit 2019, janë disbursuar mbi Euro 50 milionë në 70 kompani, Korporata dhe SME, duke i financuar për kapital qarkullues si dhe duke i mbështetur në investimet e reja, duke rritur portofolin e korporatave mbi 20% krahasuar me vitin 2018.

Në fund të vitit 2019, portofoli i kredive konsistonte në mbi 300 kompani në të gjitha industritë dhe fushat e biznesit, që dëshmon një shumëllojshmëri të klientelës dhe sektorëve.

Ne jemi shumë selektivë dhe konservativë në përzgjedhjen e investimeve të duhura në përputhje me politikatat tona të riskut dhe mbrojtjen e kapitalit të bankës. Kreditë kalojnë përmes një procesi aprovimi të konsoliduar, të detajuar dhe shumë strikt. Analiza e detajuar e sektorëve, kompanive dhe kërkesave të tyre për financim, na mundëson të investojmë në kompani dhe projekte me cilësi të lartë. Në këtë mënyrë, qëllimi ynë është mirëmbajtja e një portofoli me cilësi të lartë dhe që mund të përballojë cikle të ndryshme ekonomike. Për vitin 2019, cilësia e portofolit dëshmohej qartë nga përqindja e kredive të këqija; NPL ratio ka patur një përmirësim në 15%, nga 19% që ka qenë në vitin 2018. Për vitin 2020, është parashikuar një përmirësim akoma edhe më i lartë i cilësisë së portofolit, duke arritur të ulet norma e kredive të këqija (NPL ratio) deri në 9%.



NJËSIA BANKARE E RETAIL

2019 ka qenë një vit sfidash për Njësinë Retail që arriti me sukses, pas unifikimit përfundimtar të portofoleve dhe njehsimit të Sistemit Qendror Bankar, të ruaj e të shtoj klientelën, duke u mirë pozicionuar në tregun shqiptar me 10% të Kredive Hipotekare dhe 6% të Depozitave të Individëve.

Sfida e madhe e kalimit nga banka tradicionale në një bankë Boutique me qasje më të sofistikuar dhe integrale ndaj klientit, është tejkaluar në mënyrë të shkëlqyer falë bashkëpunimit dhe besimit të klientëve në njërën anë dhe punës me dedikim dhe pasion të stafit në krahun tjetër. Megjithëse kemi patur një periudhë ndryshimesh të mëdha kemi përcjellë siguri dhe kemi rritur standardin e shërbimit ndaj klientëve dhe termave të produkteve të ofruara.

Rrjeti i degëve ka patur një ndryshim konceptual në 2019-ën, është kaluar nga një rrjet i gjerë me 44 degë të vogla në një rrjet me 22 degë të mëdha, të mirëpozicionuara dhe moderne, që ofrojnë shërbim dhe zgjidhje integrale për klientët. Tashmë në 4 Degë Abi, klientët Premier shërbehen në ambiente të veçanta, nga staf i dedikuar me shërbim të personalizuar.

Stafi është padyshim burimi më i vyer që kemi, ndaj dhe këtë vit kemi vazhduar të rekrutojmë dhe të punësojmë staf të talentuar dhe profesionist ndërkohë që kemi krijuar një rrugë të qartë karriere për stafin ekzistues.

Këtë vit në ekipin e Retail u përfshi skuadra e SBE, një ekip i dedikuar dhe projektuar për t'i shërbyer biznesit të vogël dhe të mesëm në kredithënie dhe shërbime bankare.

Ndërkohë brenda skuadrës së Retail, spikat ekipi i Zhvilluesve të Biznesit, forcë e përbërë nga bankierë ekspertë, të talentuar dhe me network të gjerë të cilët furnizojnë degët me klientë premierë individë, biznese dhe institucione publike duke garantuar nivelin më të lartë të shërbimit ndaj klientit.

Padyshim që në 2019-ën Abi Bank ka konfirmuar që është një protagonist i rëndësishëm në tregun bankar shqiptar. Për herë të parë, në fokus u vendos edhe kredithënia për individë që kulmoi me lancimin në Prill 2019 të fushatës "Kape shtëpinë me 1%", e cila theu mitet e normave, relativisht të larta, të interesit në treg për këtë produkt.

Besimi i klientëve tashmë ka kaluar me sukses të plotë çdo provë dhe është konfirmuar me përzgjedhjen e ABI Bank si partner kryesor i biznesit për depozitat bankare gjatë fushatës së verës 2019.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Përgjegjësia sociale e korporatës është pjesë e rëndësishme e qeverisjes dhe kulturës korporative të Bankës Amerikane të Investimeve, duke ofruar një kontribut aktiv dhe vullnetar, nëpërmjet një programi të larmishëm sponsorizimesh në projekte, aktivitete dhe vepra të ndryshme bamirësie.

Fokusi ynë bazohet në katër prioritet kryesore në mbështetje të komunitetit si: Barazia Gjinore, Barazia Sociale, Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe Vullnetarizmi.

Barazia Gjinore. Të investosh në arritjen e barazisë gjinore, jo vetëm që çon në përmirësimin e jetës së vajzave dhe grave por edhe në transformimin pozitiv të mënyrës së jetuarit të djemve dhe burrave. Ne mbështesim projekte dhe shumë aktivitete të drejtuara nga femrat, që synojnë barazinë për disa grupe të nën-përfaqësuar, të tilla si gratë e dhunuara dhe të trafikuar, duke përkrahur strehëzat si qendra të kujdesit dhe ri-integrimit të tyre në shoqëri.

Barazia Sociale është një objektiv i rëndësishëm për ne, ku në fokus kemi mbështetjen ndaj asaj pjese të shoqërisë që është e izoluar dhe e cënuar nga pabarazia social-ekonomike e krijuar. Përmirësimin e kushteve të jetesës e kemi vlerësuar si kontribut të rëndësishëm ndaj shtresave të marginalizuara të komunitetit, me qëllim plotësimin e nevojave jetike dhe ndryshimit të cilësisë së jetës.

Vullnetarizmi është një ndër vlerat kryesore në kulturën e stafit tonë. Ne jemi angazhuar në nisma për mbrojtjen mjedisore, si pastrimin e plazhit të Darëzezës në Fier në mbështetje të nismës së "Fondacionit Optima" ku u grumbulluan 2 ton mbeturina, fushata solidarizuese ndaj urisë në mbështetje të Food Bank Albania duke dhuruar 2,5 ton ushqime në ndihmë të 125 familjeve shqiptare në nevojë, fushata për dhurimin e gjakut në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar në ndihmë të 57 fëmijëve talasemikë. Në rastin e fatkeqësive natyrore ne i kushtojmë rëndësi dhe kujdes të veçantë segmenteve të shoqërisë që përfshihen dhe izoloohen nga tërmetet duke mbledhur fonde dhe ofruar ndihma humanitare me përgjegjësi dhe ndjeshmëri të lartë.



ABI BANK I BASHKOHET ECJES SIMBOLIKE TË FJONGOS ROZË

Muaji Tetor është kthyer në një traditë në Shqipëri për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, si dhe për të marrë mbështetje nga shoqëria për ata që kanë mbijetuar nga kanceri dhe familjet e tyre. ABI Bank si sponsor platin për të tretin vit rradhazi i kësaj fushate i është bashkuar ecjes simbolike që u zhvillua në dt. 8 tetor në Tiranë, nën moton "Fjongo Rozë më kujton!"



KONCERTI ERMONELA JAHO

Artistja e madhe Ermonela Jaho njëkohësisht ambasadore e YWCA në Kauzën e Fjongos Rozë, në dt. 22 tetor mbajti një koncert bamirësie në mbështetje të "Fjongos Rozë", simboli ndërkombëtar i betejës kundër kancerit të gjirit. ABI Bank partner prej 3 vjetësh i shoqatës YWCA of Albania, është sponsor platin i koncertit duke treguar mbështetjen e vazhdueshme në kauza me impakt të rëndësishëm social. Të gjitha të ardhurat e këtij koncerti i kalojnë YWCA për ngritjen e një qendre psiko-sociale dhe ligjore për gratë dhe vajzat e prekura nga kanceri i gjirit dhe familjarët e tyre.



STAFI I BANKËS I BASHKOHET NISMËS SË "DHURIMIT TË GJAKUT"

ABI bank, në datën 24 Maj 2019, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, ndërmori nismën vullnetare të "Dhurimit të Gjakut", në mbështetje të fëmijëve që vuajnë nga Talasemia. Kjo nismë ishte pjesë e prioriteteve të Përgjegjësisë Sociale të Bankës, e cila u mbështet masivisht nga stafi i saj.



ABI BANK MBËSHËTET "STREHËZËN PËR GRA DHE VAJZA"

Banka Amerikane e Investimeve, në kuadër të Përgjegjësisë Sociale, ka në fokus të prioriteteve të saj barazinë gjinore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Së fundmi Banka ka mbështetur "Strehëzën për Gra dhe Vajza" të dhunuara, organizatë jofitimprurëse që ushtron funksionin e saj në qytetin e Tiranës. Projekti synoi përmirësimin e mjedisve fizike të Strehëzës si një mënyrë për të garantuar një cilësi shërbimi më të mirë dhe kushteve më të mira të jetesës. Mbështetja e ofruar bëri të mundur që e gjithë pjesa e mobilimit dhe pajisjeve hidrosanitare të amortizuara të zëvendësohej me të tjera të reja, tepër funksionale dhe komode.



ABI BANK SPONSOR I KONGRESIT "KUJDESI GJATË SHTATZËNISË DHE LINDJES"

24-26 Tetor, në Tiranë u mbajt Kongresi i 5të "KUJDESI GJATË SHTATZËNISË DHE LINDJES". ABI Bank në kuadër të përgjegjësisë sociale mbështeti ngjarjen më të madhe tekniko-shkencore në fushën e obstetrikës dhe të mëmësisë së sigurtë. Në të morën pjesë mjekët obstetër gjinekolog, mjekët e familjes dhe infermierët e fushës së obstetrikës nga e gjithë Shqipëria.



ABI BANK NË MBRËMJEN GALA TË QENDRËS STREHA

Në dt. 17 Maj, në ambientet e Hotel Plaza u organizua mbrëmja gala e përvitshme e organizuar nga aktivistët e komunitetit LGBT në Tiranë.

Në kuadër të luftës kundër diskriminimit, Banka Amerikane e Investimeve mbështeti për të katërtin vit këtë aktivitet bamirësie, misioni i të cilit ishte sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e akomodimit, ushqimit, mbështetjes psikosociale, aftësisimit për jetën, edukimin dhe punësimin për të rinjtë LGBT, të cilët janë viktimë të abuzimit dhe diskriminimit dhe jetojnë pranë Qendrës "Streha".



VULLNETARËT E ABI BANK NË AKSIONIN E PASTRIMIT TË PLAZHIT "DARËZEZË"

ABI Bank, në vijim të mbështetjes së nismave që promovojnë vullnetarizmin dhe mbrojtjen e natyrës, përkrahu iniciativën e Fondacionit "OPTIMA" për pastrimin e plazhit dhe pyllit të Darëzezës në Fier. Ky aksion u organizua ditën e shtunë, dt. 27 Prill, ku punonjësit e ABI Bank iu bashkuan vullnetarëve nga fondacioni "OPTIMA", në bashkëpunim me organizimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si edhe Bashkisë Fier, në pastrimin e mbeturinave. Ne në ABI besojmë se kontributi i përbashkët në mirëmbajtjen e ambientit është shumë i rëndësishëm, dhe duhet të jetë i përhershëm nga të gjithë qytetarët.



"SOLIDARITET KUNDËR URISË" 21-27 NËNTOR 2019

Banka Amerikane e Investimeve, në bashkëpunim me FOOD BANK ALBANIA, ndërmerr nismën vullnetare të "Dhurimit të produkteve ushqimore", në mbështetje të familjeve shqiptare në nevojë.

Kjo nismë është pjesë e prioriteteve të Përgjegjësive Sociale të Bankës, që i parapriu festës së Ditës së Falenderimeve "Thanksgiving 28 Nëntor".

Përgjatë këtyre datave patëm mundësi të kontribuojmë me një ndihmë konkrete për familjet shqiptare në nevojë, duke grumbulluar 2,5 ton produkte ushqimore të cilat u shpërndanë në 125 familje në nevojë.



ABI BANK MBËSHETET QENDRËN SOCIALE PËR FËMIJËT JETIM

Bank Amerikane e Investimeve jep në vazhdimësi suportin e saj për mbështetjen e shtresave në nevojë. ABI Bank ka dhuruar një automjet, i cili do të jetë në shërbim të komunitetit të Qendrës Sociale "Të Qëndrojmë së Bashku".

Gjithashtu ka dhuruar pajisje elektroshtëpiake për "Shtëpinë e Shpresës" në Shën Vlash Durrës. Këto pajisje do të jenë në shërbim të kësaj qendre, e cila ka në vëmendje kujdesin e fëmijëve jetim.

ABI BANK SPONSOR I EVENTIT "HALLOWEEN 70s THEME PARTY"

ABI në kuadër të përgjegjësive sociale mbështeti "Hope Albania"- Shoqatën Shqiptare të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor. Halloween 70s theme party, një festë për të luftuar stigmën dhe diskriminimin që ekziston rreth shëndetit mendor në Shqipëri. 2/3 e njerëzve me probleme të shëndetit mendor e fshihin gjendjen e tyre të vërtetë duke vënë maskën e personit pa probleme, të lumtur apo të qetë. Sllogani i këtij aktiviteti ishte #leteflasim, me qëllim sensibilizimin për



personat që vuajnë nga ky problem, të marrin më shumë guxim për të kërkuar ndihmë, ndërsa të tjerët të jenë më pak paragjyqes ndaj tyre. Në këtë event, u kombinua moda, muzika dhe kauza e mire, duke përcjellë mesazhin në mënyrë argëtuese.

ARSIM



ABI BANK SPONSOR I EVENTIT "TIRANA TECH OPEN"

25-27 Shtator "TIRANA TECH OPEN", një organizim multi-dimensional, realizuar për nxitjen e novatorizmit e krijimtarisë në sektorin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

ABI Bank mbështeti Edu Zone, Bootcamp në shërbim të të rinjve të apasionuar pas teknologjisë dhe aplikimeve të saj, objektiv i të cilës është rritja e njohurive profesionale. Nxënës të shkollave profesionale të grupmoshës 14-16 vjeç, ndoqën praktikatat të drejtuara nga mentorë të dedikuar, në një eksperiencë tre ditore. Gjatë këtyre ditëve pjesëmarrësit arritën të mësojnë si të formulojnë një ide biznesi dhe ta mbështesin atë në teknologjitë më të fundit, qafshin këto përmes programimit të faqeve web, aplikacioneve mobile apo programimit të pajisjeve GPS.

SCHOOLME AKSESOHET DHE NE BIBLIOTEKAT E VENDIT



ABI BANK SPONSOR I PLATFORMËS "SCHOOL ME"

Përgjegjësia Sociale në ABI bank, mbështet platformën "SchoolMe" duke i ofruar mundësinë për një vit të shtrihet në të gjithë bibliotekat e rikonstruara të qytetit të Tiranës si dhe në bibliotekat publike në Korçë, Elbasan, Lezhë, Shkodër. Kjo bëhet në kuadër të gjithëpërfshirjes së komunitetit të shkollave në afërsi të bibliotekave, duke i ofruar alternativa studimi për të gjithë nxënësit edhe në formatin digjital. Nëpërmjet platformës "SchoolMe" lëndët e arsimit 9-vjeçar shjehohen në shqip nga mësues të regjistruar dhe shoqërohen me video shkencore, filma, imazhe, harta specifike, të gjitha këto në përputhje me kurrikulën zyrtare, në sinkron me kalendarin shkollor. Ky projekt nxit afrimin e nxënësve me librin por edhe siguron një partneritet të qëndrueshëm mes shkollave dhe bibliotekave në zhvillimin e aktiviteteve audiovizuale përgjatë gjithë vitit shkollor.



ABI BANK MBËSHETET MBLEDHJEN E RRJETIT PËR EDUKIM FINANCIAR

13 Nëntor, Bursa Shqiptare e Titujve ALSE organizoi mbledhjen e 7-të të Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE). ABI Bank mbështeti këtë organizim në mbyllje të të cilit, të gjithë organizatat dhe institucionet anëtare të ANFE ranë dakord për rritjen e prezencës së tyre në media dhe rrjetet sociale për të qenë sa më pranë konsumatorëve me informacione publike që rrisin sensibilizimin dhe nivelin e edukimit financiar.



AKADEMIA SHQIPTARE E KIBERNETIKËS

8 - 11 korrik u zhvillua me sukses sesi i tretë i Albanian Cyber Academy, i cili zgjati 4 ditë për studentët më të mirë të fushës dhe në 12 korrik për herë të parë u zhvillua trajnimi për rritje kapacitetesh të CSIRT-eve sektoriale nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetik.

Eventet synojnë rritjen e kapaciteteve dhe thellimin e njohurive në fushën e sigurisë kibernetike, për studentët e nivelit master por gjithashtu dhe në trajtimin e kërcënimeve dhe risive në fushën e Sigurisë Kibernetike, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë deri në nivel kombëtar. ABI Bank ishte pjesë e këtyre eventeve duke treguar mbështetjen dhe vëmendjen që tregon në aktivitete apo trajnime objektivi i të cilave është rritja e njohurive profesionale.



JAVA E PARASË - KONKURSI "VIDEOJA MË E MIRË"

Me rastin e Javës së Parasë, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave organizoi konkursin "Videoja më e mirë". Ceremonia e ndarjes së cmimeve të konkurseve së Javës së Parasë, u bë në dt. 25 mars, në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Banka Amerikane e Investimeve ka mbështetur aktivitetin duke ofruar cmimet për tre vendet e para të fituara nga nxënësit e shkollave të mesme të cilët kanë konkurruar me videot e krijuara prej tyre, duke përcjellë me origjinalitet temën "Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetra!".

Përzgjedhja e videove fituese, u bazua në gjykimin e jurisë së përbërë nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Bankës Amerikane të Investimeve.

TE TJERA



MOLI I DASHURISË: DHURATA E ABI PËR TIRANËN NË KËTË SHËN VALENTIN!

Falë investimit të Bankës Amerikane të Investimeve, në Parkun e Liqenit u përrua "Moli i Dashurisë", i cili rikthen pas shumë vitesh shëtitjet me varka në liqen. Investimi më i ri, është shëtitja e re buzë liqenit dhe moli të varkave me e pa vela dhe kanoeve, si një nevojë për ta kthyer zonën në një hapësirë rekreative multifunksionale. Investimet e kryera e kanë kthyer Parkun e Madh të Liqenit Artificial në destinacionin më të preferuar për qytetarët e Tiranës, jo vetëm për të kaluar kohën e lirë por edhe për të zhvilluar aktivitete të ndryshme sportive. Banka Amerikane e Investimeve shpreh gjithmonë mbështetjen e saj në iniciativa dhe projekte që kanë qëllimin në përmirësim të ambientit dhe komunitetit ku jetojmë dhe punojmë.



DITA E VERËS 2019 – ABI BANK MBËSHJET

E gjithë Tirana u përfshi në një atmosferë festive në dt. 17 mars për të festuar Ditën e Verës 2019. Edhe stafi i ABI Bank iu bashkua festës në Sheshin Skendërbej. Qytetarët e shumtë patën mundësi të njihnin nga afër Bankën nëpërmjet standës, fletëpalosjeve të shpërndara dhe banerit të madh të Teatri i Operas dhe Baletit që uronte për ditën e festës. Banka Amerikane e Investimeve sponsor i përgjithshëm i Ditës së Verës 2019.



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E KOMISIONERËVE

22-24 Tetor është zhvilluar në Tiranë Konferenca e 41-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, një forum i rëndësishëm i bashkëpunimit dhe koordinimit të Autoriteteve botërore mbikëqyrëse të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Banka Amerikane e Investimeve ishte mbështetëse e partnere financiare e këtij aktiviteti të rëndësishëm si një mundësi shumë e mirë për shkëmbim të eksperiencave në promovimin e të drejtave të njeriut dhe sidomos, promovimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.



ABI NË "RRUGA DREJT SUKSESIT"

8-10 Nëntor 2019, u organizua Event-Trajnimi "Rruga Drejt Suksesit" nga Vasil Naçi. Një kombinim unik i përvojës dhe njohurive të Vasil Naçit, me praktikën dhe mësimet më të mira nga trajnues me famë botërore. Pas 28 viteve të suksesshme në biznes dhe dhjetra trajnimeve ndërkombëtare me udhëheqësit më të njohur në arenën e motivimit, zhvillimit personal, marketingut, lidershit dhe inovacionit, Vasil Naçi, për të katërtin vit radhazi, përcolli një kombinim njohurish, praktikash dhe strategjish për sukses të garantuar.



ABI BANK SPONSOR I PROJEKTI "SMILE ALBANIA"

ABI Bank mbështet për të dytin vit radhazi projektin "Smile Albania". 15 info point, 9 pika kufitare dhe 1'000 të rinj mirëpritën turistët duke dhënë informacion mbi vendin. Cdo ditë u shoqërua me aktivitete/festivale/festa të shpërndara si në bregdet ashtu dhe në zonat malore. ABI Bank është një nga sponsorat e projektit "Smile Albania" duke treguar mbështetjen e përhershme të projekteve të rëndësishëm që promovojnë vlerat e vendit tonë.



ABI BANK DHE REVISTA BORDO PROMOVOJNË "100 FSHATRA"

"100 fshatrat", bashkëpunim i Bankës Amerikane të Investimeve me Revistën Bordo. ABI Bank dhe revista Bordo janë bërë bashkë për të sjellë më të mirën e këtyre fshatrave. Një pjesë e tyre janë të njohur, por një pjesë e madhe krejtësisht të panjohur. Gjithçka e ilustruar me foto përmes faqeve të dedikuara në revistën e printuar dhe në website, duke i përshkruar ata në traditë, kulinari, receta tipike të zonës, pika interesi, aktivitete sportive apo kulturore, festa lokale, arkeologji e histori.



ABI BANK NË DITËN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Edicioni i tretë i Muzeut të Stilit Ethno Vibe vjen sërish për Ditën e Trashëgimisë Kulturore! Trashëgimia, tradita dhe modernia u bashkuan nëpërmjet krijimeve të stilistëve të suksesshëm shqiptar të frymëzuar nga perlat e traditës, në 28 Shtator në rrugicat e Pazarit të Korçës! ABI Bank mbështeti për të tretin vit radhazi këtë aktivitet promovues të artit dhe trashëgimisë kulturore.



ABI BANK DHE DHOMA AMERIKANE FESTOJNË 4 KORRIKUN

Banka Amerikane e Investimeve si partnere kryesore e Dhomës Amerikane të Tregtisë në Tiranë mori pjesë në organizimin e ceremonisë festive me rastin e festës së Pavarësisë së SHBA-ve. Festimeve iu bashkua edhe stafi i ABI Bank, i cili shijoi atmosferën dhe aktivitetet e shumta. ABI Bank është Platinum Sponsor i Dhomës Amerikane të Tregtisë për të katërtin vit radhazi.



PËRURIM I LIBRIT TË PROFESORIT ARDIAN CIVICI

Banka Amerikane e Investimeve mbështet botimin e librit "Udhëtim në tri kohë" të profesorit të njohur z. Adrian Civici, i cili në këtë libër shkëlqen në shpjegimin e tij akademik të tre sistemeve, komunizmit, tranzicionit dhe kapitalizmit. Në praninë e intelektualëve të fushave të ndryshme u bë dhe promovimi i këtij libri, në 23 maj në ambientet e Hotel Piazza.

ART



ABI BANK MBËSHKETET KONCERTIN "TIME CAPSULE" – CAPITAL T

Capital T ka realizuar me sukses koncertin "Time Capsule", në 20 Shtator në Sheshin "Nënë Tereza". Reperi i njohur ka performuar mbi 20 këngë nga i gjithë repertori i tij me së paku 4 këngëtarë të tjerë. Ai ka nisur të bëjë muzikë që në moshën 13 vjeçare, duke futur edhe muzikën mainstream kur ishte ende në gjimnaz. Koncerti u mundësua nga Banka Amerikane e Investimeve – Sponsor i Artë!



OLEN ÇESARI NË TIRANË

Muzikanti i mirënjohur ndërkombëtar Olen Çezari, me grupin e tij "International Clandestine Orchestra" sjellin një tjetër sukses, duke rivënë në skenë një event të paharrueshëm për publikun shqiptar në datat 23 – 24 Prill, në Pallatin e Kongreseve. Koncerti u mbështet nga Banka Amerikane e Investimeve, Sponsor Gjeneral!



RITFOLK REUNION, MUNDËSUAR NGA ABI BANK

Rikthim në muzikën e bukur të viteve '90. Pas më shumë se 20 vitesh, Abi Bank risolli në skenë të bashkuar grupin Ritfolk, në një mbrëmje që do mbahet mend gjatë. Këto janë gjërat e bukura që mundëson investimi optimist në art.



ERMAL META DHE GNUQUARTET - ABI BANK MBËSHKETET

Pas suksesit të një viti më parë në sheshin "Skënderbej", Ermal Meta është rikthyer sërish në Tiranë për një tjetër koncert të paharruar. Mbrëmjen e 4 marsit, kantautori shqiptar performoi për publikun shqiptar së bashku me "GnuQuartet", një grup i njohur instrumentistësh, në vijim të turit "Ermal Meta në Teatër me GnuQuartet" në Pallatin e Kongreseve. Një supershfaqje nga kantautori shqiptar dhe GnuQuartet u pasua me një "after party" në ambientet e ABI Lounge, ku bashkë me Ermal Metën dhe grupin morën pjesë klientë, bashkëpunëtorë e punonjës të bankës. Koncerti u bë i mundur falë mbështetjes së Bankës Amerikane të Investimeve!



ABI BANK MBËSHKETET "TINGUJ KINEMAJE"

Banka Amerikane e Investimeve mbështet për të dytin vit radhazi turin e koncerteve "Tinguj Kinemaje" të Orkestrës Simfonike të RTSH-së. Koncertet shëtisin në zona monumentale dhe turistike në disa qytete të Shqipërisë dhe kanë në repertorin e tyre muzikë nga filma të huaj dhe shqiptarë, performuar nga instrumentistët e talentuar të orkestrës Simfonike të RTSH-së.



FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I TEATRIT TË KUKULLAVE

25 maj – 1 qershor u zhvillua edicioni i dytë i Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit të Kukullave – PIF Sunshine. Në një javë, në festival u përfshinë aktivitete dhe shfaqje të trupave nga vende të ndryshme të botës. Festivali u cel me një përrallë magjike nga trupa shqiptare me shfaqjen "Atje Ku Mali Takon Hënë". ABI Bank është sponsor gjeneral i Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit të Kukullave.



ABI BANK MBËSHKETET "ANNIE MUSICAL"

ABI Bank gjithmonë në mbështetje të fëmijëve dhe zhvillimit të talenteve, sponsor gjeneral i muzikalit "ANNIE"! Një prej muzikave më të njohura e më të dashura në skenat botërore që vazhdon të shfaqet edhe sot në Broadway duke thyer rekorde në audience, kishte premierën dt. 8 qershor në Arturbina.



RUDINA PODCAST

Me Omer Kaleshin, piktorin shqiptar, aq turk dhe francez hapet cikli në youtube "Shqiptarët e Mrekullueshëm"! Një bashkëpunim i Bankës Amerikane të Investimeve dhe Rudina Xhungës me Dritare.net.



ABI BANK NË KONCERTIN E ORKESTRËS VERORE

23 Korrik, Orkestra Verore, realizoi një koncert të vecantë në Amfiteatrin e Tiranës! Në skenë u ngjiten të rinj këngëtarë, orkestra e harqeve, kori i të rinjve, fëmijë të cilët sollën një super koncert me hitet e muzikës klasike dhe moderne. Banka Amerikane e Investimeve përkrah këtë aktivitet të freskët, origjinal që promovon talentet e reja.



ABI BANK NË "SHKODRA JAZZ FESTIVAL"

Është organizuar në Shkodër edicioni i 10-të i festivalit të Jazzit dhe aktivitetet kulturore që organizohen si nderim për artistin Rrok Jakaj. Një aktivitet që ka një jetëgjatësi të tij dhe që këtë vit është shtrirë në kohë dhe vjen edhe si një shkollë për muzikantët. Janë 10 koncerte nga formacionet e ndryshme orkestrale që për dy javë më radhë zhvillohen në ambiente të hapura në zonat më karakteristike të qytetit. Banka Amerikane e Investimeve mbështet Festivalin JAZZ në Shkodër, i cili bashkon çdo vit muzikantë të njohur nga Shqipëria dhe bota.



ABI BANK NË FESTIVALIN MIK NË KORÇË

24 – 28 Korrik celet edicioni i dytë i Festivalit "Muzika Internacionale në Korçë", MIK Festival. Muzika, arti, kultura janë shpalosur për pesë netë në qytetin e bukur të Korçës. Netë të mbushura me emocione, me ngjarje të ndryshme, të cilat të cilat kanë përcjellë emra të njohur artistësh jo vetëm të muzikës dhe mjeshtra të serenatave korçare. Banka Amerikane e Investimeve mbështet për të dytin vit Festivalin MIK, një aktivitet 5 ditor që promovon artin, kulturën dhe historinë e qytetit të Korçës.



ABI BANK NË FESTËN E BIRRËS NË KORÇË

14 – 18 gusht qyteti i Korçës i zbukuruar në sheshin e Pazarit të Vjetër dhe në rrugët kryesore ka prituri qindra qytetarë për të festuar Festën e Birrës. Banka Amerikane e Investimeve shpreh mbështetjen e saj në eventet ku promovohet edhe tradita vendase.



ABI BANK NË KONCERTIN "AMERICA THE BEAUTIFUL"

"America the Beautiful" nga Kastriot Tusha & Friends, është koncerti që ABI Bank ka zgjedhur të mbështesë duke treguar kontribut të vazhdueshëm në vlerat që përcjell arti dhe kultura. Në dt. 12 korrik, në Amfiteatrin e Tiranës tenori i njohur shqiptar Kastriot Tusha ndau me Miqtë e tij Artistë, një repertor shumë pikant nga autorët më të njohur Amerikan.



ABI BANK MBËSHËTET "HEMINGWAY JAZZ FEST"

ABI Bank mbështeti eventin e shumëpritur nga gjithë fansat e muzikës Jazz "Hemingway Jazz Fest No. 7". Eventi ditor u zhvillua në dt. 21-22 korrik pranë Universitetit Politeknik Tiranë, në Sheshin Nënë Tereza. Gjatë dy netëve sheshi u gjallërua nga kombinimet e vecanta të muzikës elektronike dhe Blues, Jazz dhe Folk!



ABI BANK PREZENT NË NJË REALITY SHOW

Ka nisur në 19 mars sezoni i dytë i Hostelit më argëtues në Shqipëri. "Hostel by Anabel 2" është prodhim i Anabel Entertainment dhe autorja e programit, Dalina Buzi ka zgjedhur mënyrën e duhur për të qenë pranë target group të serialit duke e transmetuar serialin në internet, jo më në televizion. Një serial për realitetin tonë shqiptar, një program argëtues që shtrihet midis reality show dhe televizionit tradicional, frymëzuar tërësisht nga historitë dhe e përditshmja. ABI Bank si sponsor i këtij programi tregon se është në mbështetje të programeve të ndryshme artistike universale që shtrojnë rrugën drejt një mirëkuptimi më të gjerë kulturor.

ABI BANK MBËSHËTET GJYSHET MILIONERE NË RTSH

Për dhjetë javë me rradhë, në ekranin e RTSH1 u transmetua spektakli më i ri i kulinarisë dhe humorit. Një format krejtësisht origjinal, i panjohur më parë për ekranet shqiptare po mbërthen para ekranit të mëdhenj e të vegjël, por sidomos amvisat shqiptare që janë të apasionuara pas kuzhinës.



Qëllimi i këtij spektakli gatimi nuk është vetëm argëtimi, por dhe evidentimi i vlerave të kuzhinës shqiptare, pasi çdo javë gjyshet sollë eksperiencë nga më të mrekullueshmet të kuzhinës shqiptare, traditës së zonës që ato përfaqësojnë dhe mbi të gjitha pasurisë së jashtëzakonshme të produkteve tona. Ky program mbështetet nga ABI Bank, gjithmonë prezent në programe që transmetojnë optimizëm dhe frymën e garës.



"E DIELL" NË TOP CHANNEL

Një e diel tjetër e bukur, e qeshur, e lumtur dhe aq e dashur me programin e "E Diell", është rikthyer në Top Channel plot surpriza. ABI Bank sponsor i përgjithshëm i "E Diell".



"FAMILJA" NË TV KLAN

Energji, lojra, adrenalinë dhe të qeshura pafund tek Familja në moderimin e Turian Hyska! ABI Bank sponsor i përgjithshëm i "Familja".



ABI BANK MBËSHËTET "NGA E PARA" NË VIZION +

"Nga e Para", në Vizion +, një ndër formatet televizive më familjar, synon të edukojë dhe të përcjellë shije, estetike në mënyrën e jetesës dhe është një zgjidhje shumë e mirë sociale dhe humane për familje dhe individë që kanë nevojë për një ndihmë të tillë. ABI Bank sponsor gjeneral i programit "Nga e Para".

"MA JEP DORËN" NË ORA NEWS

ABI Bank mbështet një tjetër program që transmeton optimizëm dhe shpresë. "Ma jep dorën", në Ora News ndihmon me arsim e punë ata që gjenden në nevojë dhe vështirësi.



SOIRÉE: NJË MBRËMJE E BUKUR ME MIQ DHE MUZIKË

Moderatorja e njohur Jonida Shehu ka sjellë në ekranet shqiptare një program tërësisht ndryshe. Një 'talk-show' argëtues që mban emrin 'Soiree'. Duke mbledhur personazhe të ndryshëm nga fusha specifike Jonida i bashkon duke gjetur një 'pretekst' për të folur. Këngë, diskutim, debate, argëtim, të gjitha mund t'i gjeni në programin e moderatores së njohur. Banka Amerikane e Investimeve sponsor i përgjithshëm i "Soiree".

ABI BANK - EMISIONE NË RADIO

"Makinë me 2 timonë" (M2T) në Radion CLUB FM është një talk show radiofonik i dyshes (Enkel Demi dhe Edi Oga), i vetëm i pasdites në radiot shqiptare, që u drejtohet njerëzve që sapo kanë lënë punën, tejet i pasur me batuta dhe humor të këndshëm dhe zbavitës. Cdo pasdite nga ora 15.00 deri në orën 18.00, "Makinë me 2 timonë" ka një ritëm frenetik, ku muzika e programit zgjidhet nga vetë dëgjuesit. ABI Bank sponsor i "Makinë me 2 timonë", në radion Club FM.

"Dyqani i Lagjes Sime" është Radio-Novela humoristike në RADIO TIRANA. Ngjarjet zhvillohen tërësisht në ambientet e një dyqani, personazhe të ndryshëm hyjnë në dyqan duke sjellë problemet e tyre të përditëshme, nga administrata, klinikat mjekësore, shkolla, marrëdhënie familjare, personale apo shoqërore, me humor e ironi. Ngjarjet që zhvillohen në dyqan, janë të ditëve të sotme, pa anshmëri politike, fetare dhe raciale. ABI Bank sponsor i përgjithshëm i emisionit radiofonik në RADIO TIRANA.

SPORT**ABI BANK MBËSHËTET "RALLY ALBANIA" 2019**

8 – 15 qershor u zhvillua edicioni i 15-të i "Rally Albania" 2019. Një javë me aventurë duke eksploruar Shqipërinë nëpërmjet sportit. Nisja e garës u bë nga Tirana, Sheshi Skënderbej për të vazhduar në Valbonë, Voskopojë dhe Himarë.

Banka Amerikane e Investimeve ishte partner zyrtar i "Rally Albania" 2019!

**BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE MBËSHËTET SPORT KLUB STUDENTIN**

Në kuadër të përgjegjësisë sociale që ABI Bank ndjek në gjithë aktivitetin e saj, mbështetja për një jetë të shëndetshme që ushtrimi i sportit siguron, është gjithmonë në fokus. ABI Bank është sponsori kryesor për të tretin vit radhazi i të gjitha ekipeve sportive përbërëse të Klubit Sportiv "Studenti".

**DAJTI TRAIL RUNNING**

Në 21 Prill Trail Running Albania me mbështetje të Bankës Amerikane të Investimeve, organizoi vrapimin malor në Malin e Dajtit.

Mbështetja e Bankës dhe përqafimi i këtij aktiviteti në mënyrë masive nga stafi i Bankës, shënjoji dhe njëherë fokusin dhe investimin në sport dhe në jetën e shëndetshme që ABI Bank ndjek në politikën e saj të përgjegjësisë sociale.

**VOSKOPOJA TRAIL RUNNING**

15 Shtator 2019, Trail Running Albania me mbështetje të Bankës Amerikane të Investimeve, organizon edicionin e dytë të vrapimit malor (trail run) në malet e Voskopojës - Shtegu i Ujikut.

Mbështetja e Bankës tregon fokusin dhe investimin në sport dhe në jetën e shëndetshme që ndjek ABI Bank.

**AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS**

investo në optimizëm

www.abi.al

DEGËT

Tiranë / Dega Qendrore
"Rruga e Kavajës", Nd.27 H.1,
Njësia Bashkiake Nr.10, Kodi
Postar 1001

Tiranë / Dega "Samos Tower"
Rr. "Ismail Qemali", Nd.20 H.3,
Njësia Bashkiake Nr.5, Kodi
Postar 1019

Tiranë / Dega "Bajram Curri"
Blv. "Bajram Curri", përballë
Nishrakut, Zona Kadastrale 8260

Tiranë / Dega "Qendra Pajtoni"
Autostrada Tiranë - Durrës, km 1,
Godina "Pajtoni Business Center"

Tiranë / Dega "Komuna e Parisit"
Rr. "Medar Shtylla", Nd.49,H.13,
Njesia Bashkiake Nr. 5, Kodi
Postar 1019

Tiranë / Dega "Rruga e Dibrës"
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili,
përballë Vila Gold

Tiranë / Dega "Sheshi Shtraus"
Rr. Qemal Stafa, Sheshi Straus

Tiranë / Dega "21 dhjetori"
Rr. "Frosina Plaku", Nr.2

Tiranë / Dega "Rr. Elbasanit"
Blv. Bajram Curri Prane Shkolles
se Baletit

Tiranë / Dega "Kombinat"
Rr Llazit Miho P6 Sh1 Ap2

Durrës / Dega Durrës
Lagjja Nr.11, Rruga Dëshmorët,
pallati i ri në Sheshin Pranvera

Fier / Dega Fier
Lagjja "Konferenca e Pezës",
Sheshi Fitorja

Elbasan / Dega Elbasan
Lagjja Luigj Gurakuqi, Rr. "11
nëntori", Godina 31/1

**Gjirokaster / Dega
Gjirokaster**
Lagjja "18 Shtatori"

Lezhe / Dega Lezhe
Blv. "Gjergj Fishta", Sheshi
Qendror, përballë Hotel Liss

Kavajë / Dega Kavajë
Bulevardi Kryesor, Lagjja nr. 3

Korçë / Dega Korçë
Rr. "Sotir Gura", Nr.1, Lagjja 2

Vlorë / Dega Vlorë
Blv. "Ismail Qemali", Parku
Rinia

Pogradec / Dega Pogradec
Rr. "Rreshit Çollaku", (përballë
Hotel Turizmit)

Berat / Dega Berat
Blv. Kryesor, Lagjja 28 Nëntori

Shkodër / Dega Shkodër
L. "Vasil Shanto". Rr. 13
Dhjetori, Nr. 270

Lushnjë / Dega Lushnje
Shëtitorja Kongresi i Lushnjes
(pranë Postës Shqiptare)

Sarandë / Dega Sarandë
L. 1, Rr "Skenderbeu", Nr. 50,
(pranë Kishës Ortodokse)

ATMIN & OFF-SITE

Tiranë / Dega Qendrore
"Rruga e Kavajës", Nd.27 H.1,
Njësia Bashkiake Nr.10, Kodi
Postar 1001

Tiranë / Dega "Samos Tower"
Rr. "Ismail Qemali", Nd.20 H.3,
Njësia Bashkiake Nr.5, Kodi
Postar 1019

Tiranë / ATM "Sky Tower"
Rr. "Ibrahim Rugova", Nr.5, Njësia
Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019

Tiranë / Dega "Bajram Curri"
Blv. "Bajram Curri", përballë
Nishrakut, Zona Kadastrale 8260

Tiranë / Dega "Qendra Pajtoni"
Autostrada Tiranë - Durrës, km 1,
Godina "Pajtoni Business Center"

Tiranë / Dega "Komuna e Parisit"
Rr. "Medar Shtylla", Nd.49,H.13,
Njesia Bashkiake Nr. 5, Kodi
Postar 1019

Tiranë / Dega "Rruga e Dibrës"
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili,
përballë Vila Gold

Tiranë / Dega "Sheshi Shtraus"
Rr. Qemal Stafa, Sheshi Straus

Tiranë / Dega "21 dhjetori"
Rr. "Frosina Plaku", Nr.2

Tiranë / Dega "Rr. Elbasanit"
Blv. Bajram Curri Prane Shkolles
se Baletit

Tiranë / Dega "Kombinat"
Rr Llazit Miho P6 Sh1 Ap2

Tiranë / Blv. Zogu I
pranë Ministrisë së Drejtësisë

Durrës / Dega Durrës
Lagjja Nr.11, Rruga Dëshmorët,
pallati i ri në Sheshin Pranvera

Durrës / ATM "Blv. Dyrrah"
Bulevardi kryesor "Dyrrah"

Durrës / ATM "Spitali rajonal"
Spitali Rajonal Durrës, Rr.
"Aleksandër Goga"

Durrës / ATM "Shkozet"
Lagjja 14, Rr. "Tirana", Shkozet

Fier / Dega Fier
Lagjja "Konferenca e Pezës",
Sheshi Fitorja

Elbasan / Dega Elbasan
Lagjja Luigj Gurakuqi, Rr. "11
nëntori", Godina 31/1

Gjirokaster / Dega Gjirokaster
Lagjja "18 Shtatori"

Lezhe / Dega Lezhe
Blv. "Gjergj Fishta", Sheshi
Qendror, përballë Hotel Liss

Kavajë / Dega Kavajë
Bulevardi Kryesor, Lagjja nr. 3

Kavajë / ATM "Luz i vogël"
Fshati Luz i vogël, pranë Komunës

Korçë / Dega Korçë
Rr. "Sotir Gura", Nr.1, Lagjja 2

Korçë / ATM "Voskopojë"
Fshati Voskopojë, Qendër

Vlorë / Dega Vlorë
Blv. "Ismail Qemali", Parku Rinia

Vlorë / ATM "Riviera"
Blv. "Ismail Qemali", L. Pavarësia
(pranë QTU Riviera)

Pogradec / Dega Pogradec
Rr. "Rreshit Çollaku",
(përballë Hotel Turizmit)

Berat / Dega Berat
Blv. Kryesor, Lagjja 28 Nëntori

Shkodër / Dega Shkodër
L. "Vasil Shanto". Rr. 13 Dhjetori,
Nr. 270

Lushnjë / Dega Lushnje
Shëtitorja Kongresi i Lushnjes
(pranë Postës Shqiptare)

Sarandë / Dega Sarandë
L. 1, Rr "Skenderbeu", Nr. 50,
(pranë Kishës Ortodokse)

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Pasqyrat Financiare të Veçanta
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

(me raportin e audituesit të pavarur)

Raporti i auditueseve të pavarur	28
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	30
Pasqyra e fitim humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërshirëse	31
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital	32
Pasqyra e veçantë e flukseve monetare	33
1 Subjekti raportues	34
2 Bazat e përgatitjes	34
3 Ndryshime në politikat kontabël dhe shënimet shoqëruese	35
4 Politikat kryesore kontabël	36
5 Standardet e reja dhe interpretime ende të pamiratuara	54
6 Standardet e lëshuara dhe në fuqi për periudhën vjetore	53
7 Menaxhimi i rrezikut	54
8 Përmbledhje e vlerësimeve dhe gjykimeve kontabël	76
9 Vlera e drejtë e aktiveve dhe pasiveve financiare	98
10 Analiza e aktiveve, detyrimeve dhe kapital sipas maturitetit të mbetur	81
11 Mjetet monetare dhe të ngjashme	82
12 Hua dhe paradhënie bankave	82
13 Investime financiare në letra me vlerë	82
14 Huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve	85
15 Qira financiare	93
16 Aktive afatgjata materiale	94
17 Aktive afatgjata jo-materiale	95
18 Inventari dhe mjete të tjera	95
19 Aktive të vlefshme për shitje	95
20 Investime në pjesëmarrje dhe filiale	96
21 Detyrime ndaj bankave	96
22 Detyrime ndaj klientëve	97
23 Borxhi i varur	98
24 Aktive tatimore të shtyra	98
25 Provizione të tjera	99
26 Detyrime të tjera	99
27 Kapitali aksionar	99
28 Rezervat	100
29 Të ardhura neto nga interesat	101
30 Të ardhura neto nga komisionet	101
31 Të ardhura të tjera, neto	101
32 Shpenzimet e personelit	102
33 Shpenzime të tjera administrative	102
34 Tatim fitimi	102
35 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara	103
36 Çështje ligjore	103
37 Angazhimet për qiratë dhe shpenzimet për qiratë operative	103
38 Transaksionet e palevë të lidhura	104
39 Ngjarje pas datës së bilancit	105

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve të Banka Amerikane e Investimeve sh.a.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. ("Banka"), të cilat përmbajnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2019 dhe pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e veçantë të flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më datë 31 Dhjetor 2019 dhe performancën e saj financiare të veçantë dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("ISA"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e emërtuar "Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë ("Kodi IESBA") i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor 2019 të Bankës Amerikane e Investimeve sh.a.

Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2019, i përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionin tjetër. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2019 pritet të vihet në dispozicion për dhe pas datës së raportit të këtij audituesi.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacione të tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato bëhen të disponueshme dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë gabime materiale.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si dhe për sistemin e kontrollit të brendshëm i cili në masën që përcaktohet nga Drejtimi është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale si pasojë e mashtrimit apo gabimeve.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare (vazhdim)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqes në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, dhe të përdor parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likudojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lartë.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetimin, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënime shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.


Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ernst & Young - Ekspert Kontabël i Autorizuar
Deqa në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
21 Gusht, 2020
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2019

Shënime	31 dhjetor 2019 Lekë '000	31 dhjetor 2018 Lekë '000	
Aktivët			
Mjete monetare dhe të ngjashme me to	12	9,802,033	12,730,713
Hua dhe paradhënie për bankat	13	5,778,764	5,950,972
Investime financiare – VDATGJ	14	20,874,755	18,136,713
Investime financiare me kosto të amortizuar	14	10,949,919	11,205,627
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	15	24,754,762	24,721,153
Qira Financiare	16	42,279	55,835
Aktive afatgjata materiale dhe e drejta e përdorimit të aktiveve	17	1,578,060	857,285
Aktive afatgjata jo-materiale	18	157,582	142,858
Aktive tatimore të shtyra	25	22,633	25,482
Inventari dhe mjete të tjera	19	3,590,779	3,937,203
Aktive të vlefshme për shitje	20	2,336	10,075
Investime në pjesëmarrje dhe filiale	21	100,500	41,375
Totali i aktiveve		77,654,402	77,815,291
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	22	1,275,065	1,343,237
Detyrime ndaj klientëve	23	64,980,154	65,670,499
Detyrime të tjera	27	1,015,614	1,164,227
Detyrime të qirasë		486,288	-
Provizione të tjera	26	88,805	31,472
Detyrime tatimore të shtyra	25	172,208	167,577
Borxhi i varur	24	-	373,059
Totali i detyrimeve		68,018,134	68,750,071
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	28	3,450,935	3,085,459
Rezerva ligjore dhe të tjera	29	4,292,981	4,184,123
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	29	1,069,332	912,300
Fitim i akumuluar		823,020	883,338
Totali i kapitalit aksionar		9,636,268	9,065,220
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		77,654,402	77,815,291

Shënimet shpjeguese bashkëngjitur nga faqja 5 deri në 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRSHIRËSE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 Lekë '000	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018 Lekë '000	
Të ardhura nga interesat	2,852,963	1,997,520	
Shpenzime për interesa	(606,001)	(491,742)	
Të ardhura nga interes, neto	2,246,962	1,505,778	
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	291,996	167,794	
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(60,769)	(49,721)	
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto	231,227	118,073	
Rezultati neto nga veprimet me valutat (Humbje)/ të ardhura të tjera operative, neto	54,877	(24,471)	
Të ardhura të tjera, neto	(47,290)	(19,066)	
Rimarje nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet dhënë klientëve	15,16	590,595	443,871
Humbje nga zhvlerësimi i aktiviteteve financiare të tjera		(4,618)	(34,466)
Shpenzime personeli	33	(870,805)	(540,669)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	17,18	(254,181)	(107,321)
Shpenzime të tjera administrative	34	(874,358)	(686,674)
Provizioni për rreziqe dhe shpenzime, neto	26	(57,407)	(1,000)
Totali i shpenzimeve	(1,470,774)	(926,459)	
Fitimi neto, përpara tatim fitimit	960,125	678,326	
Shpenzimi i tatim fitimit	35	(211,585)	(109,295)
Fitimi neto i vitit	748,540	569,031	
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse <i>Zërat që janë ose mund të riklasifikohen në pasqyrën e fitimit humbjeve</i> Ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumentave financiare, (VDATGJ) neto nga tatimi mbi fitimin	14	157,032	357,750
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	157,032	357,750	
Totali i të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	905,572	926,781	

Shënimet shpjeguese bashkëngjitur nga faqja 5 deri në 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare të veçanta janë aprovuar më 30 korrik 2020 nga ekzekutivët e Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. dhe janë firmosur në emër të tyre prej:

Andi Ballta
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Armand Muharremi
Drejtor i Divizionit të Financës

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore dhe të tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitim i akumuluar	Totali
	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000
Gjëndja me 1 janar 2018	7,983,629	57,162	505,230	(4,720,653)	3,825,368
Impakti në aplikimin e SNRF 9	-	-	49,320	3,578	52,898
Gjëndja e modifikuar pas aplikimit të SNRF 9	7,983,629	57,162	554,550	(4,717,075)	3,878,266
Fitimi i vitit	-	-	-	569,031	569,031
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë	-	-	357,750	-	357,750
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	357,750	569,031	926,781
Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital					
Kontributi i aksionarëve nëpërmjet konvertimit të borxhit të varur (shënimi 24)	378,158	-	-	-	378,158
Përvetësimi i fitimit në rezervën ligjore	-	244,946	-	(244,946)	-
Rezerva nga bashkimi (shënimi 29)	-	3,882,015	-	-	3,882,015
Zvogëlimi i kapitalit nga humbjet e akumuluar	(5,276,328)	-	-	5,276,328	-
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	(4,898,170)	4,126,961	-	5,031,382	4,260,173
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	3,085,459	4,184,123	912,300	883,338	9,065,220
Fitimi i vitit	-	-	-	748,540	748,540
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë	-	-	157,032	-	157,032
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	157,032	748,540	905,572
Veprimet me aksionarët të regjistruara direkt në kapital					
Kontributi i aksionarëve nëpërmjet konvertimit të borxhit të varur (shënimi 24)	365,476	-	-	-	365,476
Shpërndarje dividendi	-	-	-	(700,000)	(700,000)
Rritje e rezervës ligjore	-	108,858	-	(108,858)	-
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	365,476	108,858	-	(808,858)	(334,524)
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	3,450,935	4,292,981	1,069,332	823,020	9,636,268

Shënimet shpjeguese bashkëngjitur nga faqja 5 deri në 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

3

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
		Lekë '000	Lekë '000
Fitimi përpara tatimit		960,125	678,326
Rregullime për:			
Amortizimi dhe zhvlerësimi	17,18	254,181	107,321
Fitimi nga zhvlerësimi neto i huave dhe paradhënieve dhënë klientëve	15,16	(590,595)	(470,563)
Zhvlerësimi neto i aktiveve të tjera financiare dhe aktiveve të tjera		108,325	34,466
Humbja neto nga zhvlerësimi i provizioneve të tjera operative	26	57,407	27,692
Të ardhura nga interesat, neto	30	(2,246,962)	(1,505,778)
Diferencat e përcaktuara nga kursi i këmbimit		(54,877)	24,471
Ndryshime në:			
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	13	103,016	(3,135,281)
Rezervën e detyrueshme	13	216,581	(151,416)
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	15	233,228	3,203,354
Qiraja Financiare	16	13,556	21,922
Detyrime ndaj bankave	22	(68,235)	(139,607)
Detyrime ndaj klientëve	23	(1,186,359)	819,827
Inventari dhe mjete të tjera	19	827,158	(159,260)
Aktive të vlefshme për shitje	20	7,739	-
Provizione dhe detyrime të tjera	26,27	(531,717)	478,909
Detyrime tatimore të shtyra	25	-	78,927
Interesa të arkëtuara		2,836,737	2,616,759
Interesa të paguara		(495,294)	(530,500)
Tatim mbi të ardhurat i paguar		94,387	-
Fluksi monetar neto nga aktivitetet operative		538,401	1,999,570
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese:			
Investime në pjesëmarrje dhe filiale	21	(59,125)	(20,125)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	17	(356,057)	(274,197)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	18	(62,797)	(22,508)
Blerje neto i investimeve financiare - VDATGJ	14	(2,546,956)	(1,185,544)
Blerje neto i investimeve financiare me kosto të amortizuar	14	257,854	(2,191,757)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet investuese		(2,767,081)	(3,694,131)
Fluksi monetar nga aktivitetet financiare			
Shpërndarje Dividendi		(700,000)	-
Fluksi monetar neto nga aktivitetet financiare		(700,000)	-
Zvogëlimi neto në mjete monetare dhe të ngjashme		(2,928,680)	(1,694,562)
Mjete monetare dhe të ngjashme me to më 1 janar		12,730,713	6,778,201
Mjetet monetare të ish-NBG në datën e bashkimit		-	7,647,074
Mjete monetare dhe të ngjashme me to më 31 dhjetor		9,802,033	12,730,713

Shënimet shpjeguese bashkëngjitur nga faqja 5 deri në 73 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. SUBJEKTI RAPORTUES

Banka Amerikane e Investimeve sh.a. ("Banka" e njohur më parë si Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a.), është një filial i zotëruar tërësisht nga Tranzit sh.p.k. (i zotëruar nga fonde investimi të menaxhuara nga NCH Capital Inc), një institucion financiar jo-bankar shqiptar i cili ofron mundësi financimi për shoqëritë dhe individët.

Banka u krijua fillimisht si një degë e Bankës Tregtare të Greqisë (më pas e quajtur Banka Emporiki e Greqisë S.A.) në tetor 1998. Në tetor 1999, Banka, duke u quajtur fillimisht Intercommercial Bank - Albania sh.a., ishte e autorizuar për të vepruar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar. Gjatë vitit 2001 Banka ndryshoi emrin e saj në Bankën Tregtare të Greqisë (Albania) sh.a. Më 1 mars 2004, emri i Bankës u ndryshua në Emporiki Bank Albania Sh.A.

Në qershor të vitit 2012, Banka Emporiki e Greqisë S.A. i shiti IUB Holding 100% të pjesëmarrjes së saj në filialin e zotëruar 100% të Emporiki Bank Albania sh.a. IUB Holding është një shoqëri anonime Franceze "par actions simplifiée", 100% filial i drejtpërdrejtë i Credit Agricole S.A. Në 3 shtator të vitit 2012 emri i Bankës ndryshoi në Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a.. Në tetor të vitit 2015, IUB Holding shiti 100% të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të filialit të saj, Banka Credit Agricole Shqipëri sh.a., tek Tranzit sh.p.k.. Miratimet e Rregullatorit, duke përfshirë dhe ndryshimin e emrit në Banka Amerikane e Investimeve sh.a., u finalizuan me efekt ligjor në datën 12 tetor 2015.

Më 2 shkurt 2018, Banka nënshkroi marrëveshjen për blerjen 100% të aksioneve të Banka NBG Albania sh.a.. Procesi i blerjes u finalizua më 3 korrik 2018, në vijim të aprovimit paraprak të Bankës së Shqipërisë më 6 qershor 2018. Në vijim të vendimi të Bordit të Aksionareve, në 6 shtator 2018, Banka e Shqipërisë aprovoi paraprakisht bashkimin ligjor të dy entiteteve Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka NBG Albania sh.a., duke përcaktuar si entitet mbijetues Bankën Amerikane të Investimeve sh.a. Bashkimi ligjor i dy entiteteve u finalizua më 1 tetor 2018.

Banka operon në përputhje me Ligjin Nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" të datës 18 dhjetor 2006. Banka është e licencuar për të kryer aktivitetet e kreditimit dhe depozitimit, shërbimet e pagesave në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe aktivitetet e tjera bankare në përputhje me ligjet Shqiptare.

Në 31 dhjetor 2019, kapitali i regjistruar aksionar ishte 3,450,935 mijë Lekë i përbërë nga 15,999 mijë Euro dhe 1,308,190 mijë Lekë (31 dhjetor 2018: 3,085,459 mijë Lekë i përbërë nga 12,998 mijë Euro dhe 1,308,190 mijë Lekë) të ndarë në 84,769 aksione të përbërë nga 30,644 aksione me vlerë nominale prej 42,690 Lekë dhe 54,125 aksione me vlerë nominale prej 295.59 Euro (31 dhjetor 2018: 74,617 aksione të përbërë nga 30,644 aksione me vlerë nominale prej 42,690.08 Lekë dhe 43,973 aksione me vlerë nominale prej 295.59 Euro).

Zyra Qëndrore e Bankës është e vendosur në Tiranë në Rrugën e Kavajës, Godina 27 kati 8 hyrja 1. Banka operon vetëm në Shqipëri me një rrjet prej 23 degësh më 31 dhjetor 2019 (31 dhjetor 2018: 33 degë dhe 1 agjensi).

Banka ka 372 të punësuar më 31 dhjetor 2019 (31 dhjetor 2018: 469), nga të cilët 231 (31 dhjetor 2018: 269) janë të punësuar në Zyrën Qëndrore.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata për përputhshmërinë rregullative

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të vecanta të Bankës janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të instrumenteve të borxhit me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse, të cilat maten me vlerë të drejtë, aktivet e mbajtura për shitje, të cilat maten me vlerën e drejte minus koston për ti shitur, dhe inventarit, i cili matet me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

(c) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Keto pasqyra financiare të vecanta të Bankës janë paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës. Gjithë informacioni i paraqitur në Lekë është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur është shprehur ndryshe.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABELË DHE SHËNIMET SHOQËRUESE

Ne keto pasqyra financiare të veçanta Banka ka aplikuar SNRF 16 nga 1 Janar 2019. Natyra dhe efekti i ndryshimeve si rezultat i miratimit të këtij standardi të ri përshkruhen në Shënimin 3.1 më poshtë. Disa ndryshime dhe interpretime të tjera aplikohen për herë të parë në 2019, por nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës. Me përjashtim të ndryshimeve më poshtë, Banka ka zbatuar vazhdimisht politikat e kontabilitetit siç përcaktohet në Shënimin 4 për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare. Efekti i fillimit të zbatimit të këtyre standardeve është i kufizuar në SNRF 16 dhe kryesisht i atribuohet si ne vijim:

3.1 SNRF 16 Qira

SNRF 16 zëvendëson SNK 17 Qiradhëniet dhe interpretimet e ndërlidhura. Standardi përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe detajimin e qirave dhe kërkon që qiramarrësit të beje njohjen e shumicës së qirave në bilanc. Banka aplikoi SNRF 16 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive të aplikimit në datën 1 Janarit 2019, pa riparaqitjen e krahasimeve.

Banka ka zgjedhur të përdore përjashtimet e propozuara nga standardi në kontratat e qirasë për të cilat afati i qirasë perfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar, dhe kontratat e qirasë për të cilat aktiviteti themelor ka vlerë të ulët.

Qiradhëniet llogariten më parë si qira operative

Banka njohu të drejtën e përdorimit të aktiveve dhe detyrimet e qirasë për ato qira të klasifikuara më parë si qira operative, me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. E drejta e përdorimit të aktiveve njihen bazuar në shumën e barabartë me detyrimet e qirasë, rregulluar për çdo pagesë të parapaguar dhe qirasë së akorduar të njohur më parë. Detyrimet e qirasë u njohën bazuar në vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, skontuar me normën e huamarrjes shtesë në datën e aplikimit fillestar.

Banka gjithashtu aplikoi mjetet në dispozicion nga praktika ku ajo:

- U mbështet në vlerësimin e saj nëse qirat janë të mëdha menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar
- Aplikoi përjashtimet e qirave afatshkurtra në qiratë të cilave afati i përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar
- Përjashtoi kostot fillestare direkte nga matja e të së drejtës së përdorimit të aktivitetit në datën e aplikimit fillestar
- Mbikëqyrje e përdorur në përcaktimin e afatit të qirasë, ku kontrata përmbante opsione për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Bazuar në sa më sipër, më 1 janar 2019:

- E drejta e përdorimit të aktiveve prej 571 milion lekësh u njohën dhe u prezantuan në pasqyrën e pozicionit financiar në "Aktive afatgjata material dhe të drejtat e përdorimit të aktiveve"
- U njohën detyrime shtesë për qiranë prej 571 milion lekësh (të përfshira në "Detyrimet e qirasë")
- Aplikimi i SNRF 16 nuk pati asnjë ndikim në rezervat e Bankës.

Detyrimet e qirasë në 1 janar 2019 mund të rakordohet me angazhimet e qirasë operative që nga 31 dhjetori 2018, si vijon:

Aktivet	million Lekë
Angazhimet e qirasë operative më 31 dhjetor 2018	502
Norma mesatare rritese e ponderuar e huamarrjes, që nga 1 janar 2019	4.766 %
Detyrimet e zbritura të qirasë operative që nga 1 janar 2019	358
Zbritur:	
Angazhimet që lidhen me qiratë afatshkurtra	-
Angazhimet në lidhje me qiradhëniet e pasurive me vlerë të ulët	-
Shtuar:	
Pagesat e qirasë që lidhen me periudhat e rinovimit që nuk përfshihen në angazhimet e qirasë operative më 31 dhjetor 2018	213
Detyrimet e qirasë në 1 janar 2019	571

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

Siç paraqitet në Shënimin 4.h), Banka nuk riklasifikon aktivet e saj financiare pas njohjes fillestare të saj, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përmendura në Standard. Gjatë vitit 2019, Banka identifikoi që një pjesë e instrumenteve të saj financiarë në VDATGJ të marra nga bashkimi me NBG, e mbajtën klasifikimin e tyre të mëparshëm si VDATGJ në vend që të klasifikoheshin nën politikën e Bankës. Në vitin aktual, Banka rishikoi klasifikimin e këtij portofoli si Kosto e Amortizuar në përputhje me Modelin e Biznesit të Bankës për të gjitha letrat me vlerë të ndryshueshme. Riklasifikimi nuk ka ndikuar në matjen e aktiveve pasi vlera e drejtë në datën e blerjes fillestare përmes bashkimit nuk ndryshon nga kostoja e amortizuar dhe nuk ka ndikim në fitim ose humbje. Shikoni shënimin 14 për më shumë detaje.

SNRF 16 Qiradhëniet janë zbatuar nga 01 janari 2019 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive përmes së cilës njihet një aktiv i detyrimit të përdorimit dhe detyrimi i qirasë (për më shumë detaje referojuni Shënimin 3.1). Përveç këtyre ndryshimeve, Banka ka zbatuar vazhdimisht politikën e mëposhtme të kontabilitetit në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç standardit të ri.

a) Filiali dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Banka përgatit pasqyrat financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të. Filialet mbahen me kosto në pasqyrat financiare të veçanta. Banka nuk përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi Mëma, Tranzit shpk përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Informacioni mbi interesin për subjektet e tjera paraqitet në Shënimin 21.

b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në atë datë. Fitim ose humbja nga kursi i këmbimit mbi zërat monetare është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetarë të matura me vlerë të drejte në monedhë të huaj, këmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Zerat jo-monetarë në monedhë të huaj të matura me kosto historike këmben duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që vijnë nga kurset e këmbimit njihen përgjithësisht në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura për këmbimin e balancave në monedhë të huaj për vitin 2019 dhe 2018 janë si më poshtë (në Lekë):

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
1 USD	108.64	107.82
1 EUR	121.77	123.42
1 GBP	143.00	137.42

c) Interesat

Të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI") për të gjithë instrumentet financiare të matur me koston e amortizuar, instrumentet financiare të dizenuar më Vlerë të Drejtë në fitim humbje ("VDFH"). Të ardhurat nga interesat për instrumentet financiare që sipas SNRF 9 maten me Vlerë të Drejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ"), klasifikohen si të vlefshme për shitje ose mbajtur deri në maturim, gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma, me të cilën skontohen ekzaktesisht pagesat e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose kur është e përshtatshme, për periudhën më të shkurter, duke arritur në vlerën kontabël neto të aktivitetit financiar.

NEI (dhe për këtë dhe kosto e amortizuar e një aktiviteti) përllogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim apo prim në blerje, komisionet dhe kosto të tjera që janë pjesë integrale e NEI-t. Banka njihet të ardhurat nga interesat duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një normë konstante kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Për këtë njihet efektin e normave të ndryshme të interesit të aplikuar në fazat e ndryshme, dhe karakteristika të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet, gjokat dhe komisionet).

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

c) Interesat (vazhdim)

Nëse pritjet në lidhje me flukset e parave në aktivin financiar rishikohen për arsye të tjera nga rreziku i kredisë, rregullimi regjistrohet si një rregullim pozitiv ose negativ i vlerës kontabël të aktivitetit në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar me një rritje ose ulje të interesit të ardhura.

Rregullimi amortizohet në vijim nëpërmjet të ardhurave nga operacionet bankare në pasqyrën e e fitim humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Interesat dhe te ardhura te ngjashme

Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar NEI mbi vlerën bruto të aktivitetit financiar, që nuk janë aktive të zhvlerësuar. Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye quhet si "Faza 3", Banka i përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit mbi vlerën neto të aktivitetit financiar. Nëse aktiviteti financiar përmiresohet dhe nuk është më i zhvlerësuar, Banka e ndryshon llogaritjen e të ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto të tij.

Për aktivitetet financiare të blera apo të krijuara të zhvlerësuar ("POCI") (siç shpjegohet në shënimin 4.j), Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke përllogaritur NEI-in të rregulluar dhe më pas duke e aplikuar atë normë mbi koston e amortizuar të aktivitetit.

NEI i rregulluar është norma e interesit, e cila në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme të parashikuara (duke përfshirë dhe humbjen kreditore) në vlerën e amortizuar të aktivitetit POCI.

d) Tarifat dhe komisioni - Të ardhurat nga shërbimet bankare te klientët

Banka fiton të ardhura nga tarifa dhe komisioni nga një gamë e larmishme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Tarifat dhe të ardhurat nga komisioni dhe shpenzimet që janë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Tarifat e shërbimit dhe komisionet për të cilat Banka merr përsipër një detyrim të performancës ndaj klientëve, njihen si të hyra bankare dhe llogariten sipas SNRF 15 Të ardhurat nga kontrata me klientët. Termat dhe kushtet e shërbimit të Bankës (kontratat) zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, të përfshira nën një konsideratë, rrjedhimisht nuk ka ndonjë gjykim të rëndësishëm për shpërndarjen e çmimit të transaksionit.

Për më tepër, shërbimet bankare të ofruara nga banka kanë një kohëzgjatje jo më shumë se një vit ose rinovohen në bazë vjetore (për shembull, mirëmbajtja e llogarisë). Rrjedhimisht, Banka ka përdorur një shfrytëzues praktik të standardit dhe nuk ka nevojë të paraqesë informacione për shumën e përgjithshme të çmimit, në lidhje me pjesën e pakënaqur të detyrimeve të performancës.

Kënaqësia e detyrimeve të performancës kryhet ose në një pikë të kohës kur me të ardhurat nga komisioni njihet kur shërbimi është ekzekutuar dhe transferuar te klienti, ose me kalimin e kohës kur nga Banka kryen shërbimin për një periudhë të dakorduar dhe klienti e konsumon atë si shërbimi është duke u kryer, dhe të ardhurat njihen gjatë periudhës në fjalë.

Të ardhurat nga komisionet mund të ndahen në tre kategoritë e mëposhtme:

• Të ardhurat nga komisionet të fituara nga shërbimet që sigurohen gjatë periudhës

Komisionet e fituara për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhës njihen gjatë kësaj kohe. Këto komisione përfshijnë komisione për mirëmbajtje llogarie, kartë dhe shërbim E-banking.

• Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbimet financiare dhe nga ekzekutimi i transaksioneve në një kohë të caktuar

Ketu përfshihen Të ardhurat nga komisioni të njohura në një kohë të caktuar zakonisht kanë të bëjnë me transaksionin. Ato përfshijnë tarifa nga porositë e pagesës dhe transferimit të klientëve, dhe shërbimet e tjera bankare të ofruara. Tarifat e shërbimeve të huasë që nuk janë pjesë e normës efektive të interesit, përfshirë komisionet e sigurimeve, njihen gjithashtu kur shërbimi kryhet dhe transferohet te klienti. Këto tarifa ose përbërës të tarifave që janë të lidhura me një performancë të caktuar dhe njihen si shërbime të lidhura.

Tarifat e tjera dhe të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet lindin në shërbimet financiare të operuara nga Banka dhe njihen kur shërbimi përkatës sigurohet ose pranohet.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

e) Shpenzime për tatimet

Shpenzimet për tatimet përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë, që njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes së periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme për të ardhurat e tatueshme ose për shpenzimet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual e pagueshme ose e arkëtueshme është vlerësuesi më i mirë i shpenzimit të pritshëm taksativ për t'u paguar ose arkëtuar që reflekton pasiguri lidhur me tatim fitimin, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të miratuar parimisht në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në kontabilitet as në fitimin ose humbjen e tatueshme. Aktivitetet tatimore të shtyra njihen mbi humbjet tatimore të mbartura, të drejtat tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme duke konsideruar fitime të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave të mund të përdoren. Aktivitetet tatimore të shtyra rishikohen në cdo date raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është i mundur realizimi i përfitimit tatimor respektiv; reduktimet e tilla sistemohen, kur probabiliteti i fitimit të tatueshëm në të ardhmen përmirësohet. Aktivitetet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në cdo date raportimi dhe njihen deri në masën e fitimit të ardhshëm të tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato mund të përdoren. Tatimi i shtyre llogaritet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin e rimarrjes, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

f) Instrumentet financiare – njohja fillestare

I. Data e njohjes

Banka njih fillimisht huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve, depozitat, letrat me vlerë të emetuara dhe detyrimet e varura në datën në të cilën janë origjinar. Blerjet e zakonshme dhe shitja e aktiveve financiare njihen në datën e tregëtimit në të cilën Banka angazhohet për të blere apo shitur aktivin. Të gjithë aktivitetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregëtimit në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kreditë dhe paradhëniet dhënë klientëve njihen kur fondet janë transferuar në llogaritë e klientëve. Banka njih detyrimet ndaj klientëve kur fondet janë transferuar në Bankë.

II. Njohja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga termit e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumente. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruar si aktive që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDFH"), për cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme maten me cmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga cmimi i transaksionit, Banka regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së parë, sic përshkruhet më poshtë.

III. Fitimi ose humbja e Ditës së parë

IV. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti ndryshon nga vlera e drejtë në njohjen fillestare dhe vlera e drejtë bazohet në teknika vlerësimi që përdorin vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njih diferencën midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregëtimit. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet në kohë dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti reregjistrohet.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

f) Instrumentet financiare – njohja fillestare (vazhdim)

V. Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare në bazë të modelit të biznesit për menaxhimin e aktiveve dhe si dhe kushteve kontraktuale të aktiveve të matura me:

• koston e amortizuar

• VDATGJ

g) Aktive dhe detyrime financiare

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të huave dhe garancive financiare, maten me kosto të amortizuar ose me VDFH kur mbahen për tregtim ose përcaktimi i vlerës së drejtë është i aplikueshëm. Shpjeguar në politikën kontabël 4.g.

Huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët dhe investimet financiare me kosto të amortizuar

Banka vlerëson huatë dhe paradhëniet për bankat, klientët dhe investime të tjera financiare vetëm me kosto të amortizuar nëqoftëse të dy kushtet e mëposhtme plotësohen:

• Aktivitetet financiare mbahen me një model biznesi me qëllimin për të mbledhur flukse monetare kontraktuale.

• Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e specifikuar flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe interesat për shumën e papaguar të tij.

Detajet e këtyre kushteve përshkruhen më poshtë.

Përcaktimi i modelit të biznesit

Ndryshimi ndalon njësitë ekonomike të zbresin nga kostoja e një elementi të aktiveve afatgjata materiale (AAM), të gjitha të ardhurat nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa e sjellin atë aktiv në vendin dhe gjendjen e nevojshme që ajo të jetë e aftë të veprojë në këtë mënyrë. të destinuara nga menaxhimi. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike njih të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostot e prodhimit të këtyre artikujve, në fitim ose humbje.

Ndryshimi duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive vetëm për zetat e AAM të vënë në dispozicion për përdorim në ose pas fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur kur njësi ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin.

AIP SNRF 9 Instrumentet Financiarë - Tarifat në testin e '10 përqind 'për mosnjohjen e detyrimeve financiare, efektive në ose pas 1 Janarit 2022

Ndryshimi sqaron tarifën që një njësi ekonomike përfshin kur vlerëson nëse kushtet e një detyrimi të ri financiar ose të modifikuar janë thelbësisht të ndryshëm nga kushtet e detyrimit origjinal financiar. Këto tarifa përfshijnë vetëm ato të paguara ose të marra ndërmjet huamarrësit dhe huadhenesit, duke përfshirë tarifën e paguara ose të marra nga huamarrësi ose huadhenesi në emër të tjetrit. Nuk ka ndonjë ndryshim të ngjashëm të propozuar për SNK 39.

Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në detyrimet financiare që modifikohen ose shkëmbehen në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PAMIRATUARA (VAZHDIM)

Ndryshim në SNRF 16: Koncesione qiraje të lidhura me Covid-19, efektive në ose pas 1 qershorit 2020

Si një praktikë praktike, një qiramarrës mund të zgjedhë të mos vlerësojë nëse një koncesion qiraje në lidhje me covid-19 nga një qiradhenës është një modifikim i qirasë. Një qiramarrës që i bën këto zgjedhje llogarit për çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga koncesioni i qirasë në lidhje me covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk do të ishte një modifikim i qirasë.

Përmirësimi praktik zbatohet vetëm për koncesionet e qirasë që ndodhin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë covid-19 dhe vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Ndryshimi në pagesat e qirasë rezultojnë në konsideratë të rishikuar për qiranë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shpërblimin për qiranë që i paraprinë menjëherë ndryshimit.
- Çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesa që fillimisht u paguan më ose para 30 qershorit 2021 (për shembull, një koncesion qiraje do të plotësonte këtë kusht nëse rezultojnë në pagesa të reduktuara të qirasë para 30 qershorit 2021 dhe rritje të pagesave të qirasë që shtrihen përtej 30 qershorit 2021).
- Nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

Qiramarrësit do të zbatojnë mjetin praktik retrospektiv, duke njohur efektin kumulativ të fillimit të zbatimit të ndryshimit si një rregullim i bilancit fillestar të fitimeve të mbajtura (ose përbërësit tjetër të kapitalit, siç është e përshtatshme) në fillim të periudhës raportuese vjetore në të cilën është ndryshimi. aplikuar së pari.

Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente, efektive më ose pas 1 janarit 2022

E drejta për të shtyrë shlyerjen

Nëse e drejta e një njësie ekonomike për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi i nënshtrohet njësisë ekonomike në përputhje me kushtet e specifikuar, njësi ekonomike ka të drejtë të shtyjë shlyerjen e detyrimit në fund të periudhës së raportimit nëse është në përputhje me ato kushte në atë datë.

Ekzistenca në fund të periudhës raportuese

Ndryshimet sqarojnë gjithashtu se kërkesa për të drejtën për të ekzistuar në fund të periudhës së raportimit zbatohet pavarësisht nëse huadhenësi teston për pajtueshmëri në atë datë apo në një datë të mëvonshme.

Pritjet e menaxhimit

SNK 1.75A është shtuar për të sqaruar se 'klasifikimi i një detyrimi nuk preket nga gjasat që njësi ekonomike të ushtrojë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit'. Kjo është, qëllimi i menaxhimentit për t'u vendosur në një periudhë afatshkurtër nuk ndikon në klasifikim. Kjo vlen edhe nëse shlyerja ka ndodhur kur pasqyrat financiare janë të autorizuara për lëshim.

Kuptimi i termit 'shlyerje'

Shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit te vet njësisë ekonomike konsiderohet shlyerje për qëllim të klasifikimit të detyrimeve si korente ose jo-korente, me një përjashtim. Në rastet kur një opsion shndërrimi klasifikohet si një detyrim ose pjesë e një detyrimi, transferimi i instrumenteve të kapitalit neto do të përbënte shlyerjen e pasivit me qëllim të klasifikimit të tij si aktual ose jo-aktual. Vetëm nëse vetë opsioni i konvertimit klasifikohet si një instrument i kapitalit neto, shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit të vet nuk do të merret parasysh kur përcaktohet nëse detyrimi është aktual ose jo rrjedhës. E pandryshuar nga standardi aktual, një qarkullim i huamarrjes konsiderohet zgjatje e një detyrimi ekzistues dhe për këtë arsye nuk konsiderohet të përfaqësojë 'shlyerje'.

Ndryshimet në SNRF 3: Përkufizimi i një biznesi, efektive më ose pas 1 Janarit 2020.

Ndryshimet në SNRF 3: Referenca në Kuadrin Konceptual, efektive më ose pas 1 Janarit 2022.

Ndryshimet në SNK 37: Kontrata të vështira - Kostot e Përbushjes së Kontratës, efektive më ose pas 1 Janarit 2022

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PAMIRATUARA (VAZHDIM)

AIP SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Filiali si adoptues për herë të parë, efektiv më ose pas 1 Janarit 2022.

AIP SNK 41 Bujqësia - Taksimi në matjet e vlerës së drejtë, efektiv më ose pas 1 Janarit 2022.

Shitja ose Kontributi i Aseteve ndërmjet një investitori dhe ndërmarrjes së tij të përbashkët ose ndërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28.

7. STANDARDET E LËSHUARA DHE NË FUQI PËR PERIU DHËN VJETORE

Standartet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale, por adaptimi i tyre nuk ka sjellë ndryshim në politikat kontabël të Bankës:

KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat

Interpretimi adreson kontabilitetin e taksave mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri që ndikon në zbatimin e SNK 12 Taksat mbi të Ardhurat. Ai nuk vlen për taksat ose taksat jashtë sferës së SNK 12, as nuk përfshin specifikisht kërkesat në lidhje me kamatën dhe gjokat që lidhen me trajtime tatimore të pasigurt. Pas miratimit të Interpretimit, Banka konsideroi nëse ka ndonjë pozicion të pasigurt tatimor. Interpretimi nuk ka ndikuar në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare" - Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ

Sipas SNRF 9, një instrument i borxhit mund të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që flukset monetare kontraktuale janë "vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar" (kriteri "SPPI") dhe instrumenti mbahet brenda modelit të duhur të biznesit për atë klasifikim. Ndryshimet në SNRF 9 sqarojnë se një aktiv financiar kalon kriterin SPPI, pavarësisht nga ngjarja apo rrethana që shkakton përfundimin e hershëm të kontratës dhe pavarësisht se cila palë paguan ose merr kompensim të arsyeshëm për përfundimin e hershëm të kontratës. Ndërprerja e parakohshme mund të rezultojë nga një afat kontraktues ose nga një ngjarje jashtë kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si një ndryshim në ligj ose rregullore që çon në përfundimin e hershëm të kontratës. Kur parapagimi është bërë me vlerën aktuale të drejtë ose në një shumë që përfshin vlerën e drejtë të koston për të përfunduar një instrument mbrojtës të lidhur, Banka vlerëson flukset monetare specifike kontraktuale për instrumentet përkatëse të borxhit në mënyrë që të përcaktojë nëse ato plotësojnë SPPI kriter. Këto ndryshime nuk patën asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Standartet e mëposhtme janë lëshuar dhe janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2019, por që nuk kanë ndonjë ndikim për Bankën.

- **Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkëta - Ndryshimet në SNK 28**, ndryshimet sqarojnë se një njësi ekonomike që zbaton SNRF 9 për interesat afatgjata në një shoqëri ose ndërmarrje të përbashkët, për të cilën nuk zbatohet metoda e kapitalit neto, por që, në thelb, përbëjnë një pjesë të investimit neto në shoqëri ose ndërmarrje të përbashkët (interesat afatgjata).
- **Amendamenti i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja - Ndryshimet në SNK 19**, ndryshimet adresojnë kontabilitetin kur amendamenti i planit reduktimi ose zgjidhja ndodh gjatë një periudhe raportimi.
- **Cikli Vjetor i Procesit të Përmirësimit 2015 - 2017 (lëshuar në Dhjetor 2017):**
 - **SNRF 3** Kombinime të Biznesit - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët,
 - **SNRF 11** Marrëveshjet e Përbashkëta - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët.
 - **SNK 12** Taksat mbi të Ardhurat – Pasojat e tatimit mbi të ardhurat nga pagesa në instrumente financiare të klasifikuara si kapital.
 - **SNK 23** Shpenzimet e huamarrjes – Shpenzimet e huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- menaxhimi i kapitalit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj cdo rreziku të përmendur më lart, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset e Bankës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi i Drejtuesve ka përgjegjësi për vendosjen dhe mbikqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Çështjeve Sensitive (SAC), dhe komitetin e Provizionimit, të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtuesve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë hartuar që të evidentojnë dhe të analizojnë rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut.

Banka nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i Auditit i Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Për të kryer funksionet e veta Komiteti i Auditit mbështetet nga Auditit i Brendshëm. Auditit i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Auditit.

(a) Rreziku i kredisë

Gjatë aktivitetit normal të saj, Banka ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, nga investimet në letra me vlerë dhe në zëra të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se huamarrësi ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale, dhe ky rrezik buron kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e klientëve dhe nga letrat me vlerë të borxhit dhe financimet ndaj institucioneve financiare ose zëra të tjerë jashtë bilancit. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospërmbushjes së detyrimit individual, rreziku sovran ose i industries). Banka menaxhon rrezikun e ekspozimit të kredisë sistematikisht duke monitoruar drejtëpërdrejtë limitet e kredive, portofolin e kredive dhe përqëndrimin e ekspozimit.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kredisë së Bankës. Sektori i Rrezikut të Kredisë, që raporton paralelisht tek Drejtori Ekzekutiv, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kreditit të Bankës. Menaxhimi i rrezikut të kredisë realizohet përmes:

Krijimit të politikave të rrezikut të kredisë në konsultim me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me kriteret rregullatore dhe ligjore.

Vendosjes dhe monitorimit të niveleve të delegimit dhe procesit të shkallëzimit në lidhje me miratimet e kredisë. Bordi i Drejtuesve i ka deleguar Komitetit të Kredisë autoritetin për miratimin e shumave deri në ekuivalentin e 3,000,000 EURO për rritjen e limiteve ekzistuese të kredive apo dhënien e kredive të reja, dhe deri në ekuivalentin 5,000,000 EURO për rinovimin dhe ristrukturimin e kredive aktuale. Megjithatë për financimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë dhe palëve të tjera të cilat konsiderohen me rrezik të tilla si sektori i lojërave të fatit, institucionet financiare, personat politikë, fondacionet etj., autoriteti për miratimin e kredive i mbetet Bordit të Drejtorëve pavarësisht shumës së financimit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

Rishikimit dhe vlerësimit të rrezikut të kredisë. Menaxhimi i Bankës dhe Sektori i Vlerësimit të Rrezikut të Kredisë vlerëson të gjithë kufinj të ekspozimit të kredisë, përpara miratimit përfundimtar nga autoriteti kompetent. Rinovimet dhe rishikimet e huave janë subjekt i po të njëjtit proces.

Kufizimit të përqëndrimit të ekspozimit ndaj kundërpartive, qofshin përqëndrime gjeografike apo sektorë të ekonomisë (për kreditë dhe paradhëniet) dhe sipas emetuesit, klasifikimit të kredive, likuiditetit të tregut dhe shtetit (për investimet në letra me vlerë).

Zhvillimit të mirëmbajtjes së sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës për të kategorizuar ekspozimin sipas shkallës së rrezikut të humbjes financiare me të cilën përballet Banka dhe për të fokusuar drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Klasifikimi i rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur mund të kërkoet zhvlerësim kundrejt ekspozimeve specifike të kredisë. Kuadri aktual i klasifikimit të rrezikut konsiston në pesë kategori: a) standarde, b) në ndjekje, c) nën-standarde, d) e dyshimtë dhe e) humbur. Kreditë e klasifikuara në dy kategoritë e para konsiderohen si kredi pa probleme. Kreditë e tre kategorive të tjera konsiderohen si kredi me probleme. Përveç kriterit të ditëvonesave, Banka gjithashtu përdor kriteret cilësore të mëposhtme për përcaktimin e kategorizimit të rrezikut të kredive:

- Aftësia paguese
- Kushtet financiare
- Aftësitë menaxhuese
- Kolateralin dhe garantët
- Struktura e kredive

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe për të cilat Banka ka bërë lëshime që përndryshe nuk do të konsideronte. Kreditë me kushte të rinegociueshme janë konsideruar si të zhvlerësuar individualisht në vitin e parë që nga implementimi i ristrukturimit.

Rreziku i angazhimeve të lidhura me kredinë

Banka vë në dispozicion të klientëve garanci që mund të kërkojnë që Banka të bëjë pagesa në emër të tyre dhe të hyje në angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për të siguruar nevojat e tyre për likuiditet. Letrat e kreditit dhe garancitë (duke përfshirë edhe letrat e kreditit në gatishmëri) angazhojnë Bankën për të bërë pagesa në emër të klientëve në rast të një akti të veçantë, në përgjithësi lidhur me importin ose eksportin e mallrave. Këto angazhime e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme për kreditë dhe zbuten nga të njëjtat procese dhe politika të kontrollit.

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit

Banka konsideron një instrument financiar të dështuar (humbur), dhe për rrjedhojë e kategorizon si Faza 3 për të përlogaritur HKP, në të gjitha rastet kur kredimarrësi është në vonesë mbi 90 ditë për detyrimet kontraktuale të tij. Banka konsideron balancat e thesarit dhe të tregut ndërbankar të dështuara, dhe merr masa të menjëhershme, kur pagesa e pritshme nuk është ekzekutuar në ditën e caktuar sipas kontratës mes palëve. Si pjesë e vlerësimit cilesor nëse një klient është në dështim, Banka gjithashtu konsideron një varietet elementësh të cilët mund të tregojnë pamundësi pagese. Në rast të një ngjarje të tillë, Banka me kujdes konsideron nëse ngjarja mund të rezultojë në trajtimin e klientit si të dështuar, e për rrjedhojë ta kategorizojë nën Fazën 3 apo Fazën 2 si më të përshtatshmen për të përlogaritur HKP. Ngjarje të tilla përfshijnë:

- Vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- Shkelja e një kovenanti, si mospagimi ose ngjarje me ditë vonesa;
- Huadhënësit e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale të lidhura me vështirësi ekonomike të huamarrësit, i kanë bërë një lëshim huamarrësit që huadhënësi nuk do ta kishte konsideruar në rrethana të tjera;
- Është duke u bërë e mundshme që huamarrësi të falimentojë ose të bëjë një ri-organizim financiar;
- Zhdukja e një tregu aktiv, si rezultat i vështirësive financiare;
- Blerja ose origjinimi i një aktivi financiar me një ulje të madhe që reflekton humbjet e pësuar të kredisë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit (vazhdim)

Është politika e Bankës që të konsiderojë një instrument financiar si “të përmirësuar” dhe për rrjedhojë ta heqë nga Faza 3, kur asnjë prej kriterëve të klasifikimit si dështim nuk janë prezente. Vendimi nëse një aktiv i përmirësuar do të klasifikohet nën Fazën 2 apo në Fazën 1, përcaktohet nga kriteret e vendosura në momentin e përmirësimit.

Kriteri i Bankës për qëllimet e HKP-së është më pak i rreptë sesa kërkesa për 24 muajsh e ristrukturimit, që shpjegohet në shënimin 4.n.

Rritja e qënësishme e rrezikut kreditor

Banka në mënyrë të vazhdueshme monitoron të gjithë aktivet e saj të cilat janë subjekt i HKP-së. Me qëllim që të përcaktojë nëse një instrument financiar është subjekt i HKP 12 mujore (Faza 1) apo AGJHKP (Faza 2), Banka vlerëson nëse ka pasur rritje të qënësishme të rrezikut kreditor. Banka aplikon gjithashtu një metodë të dytë qualitative për të shkaktuar një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë për një aktiv, si lëvizja e një klient/objekti në listën e vëzhgimeve, ose llogaria të bëhet e pavlefshme. Në raste specifike, Banka mund të konsiderojë gjithashtu dhe ngjarje të shpjeguara në shënimin 9 që janë një rritje e rëndësishme në rrezikun e kredisë në krahasim me një mospagim. Për më tepër, nëse pagesat kontraktuale kanë më shumë se 30 ditë vonesë, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur në mënyrë të ndjeshme që nga njohja fillestare. Kur vlerësohen HKP-të në baza kolektive për grupe aktivësh të ngjashme (si në shënimin 9), Banka aplikon të njëjtat principe për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë.

Ekspozimi në dështim

Ekspozimi në dështim (EAD) përfaqëson vlerën bruto të instrumenteve financiare të cilat janë subjekt i përlogaritjes së zhvlerësimit, duke adresuar si aftësinë e klientit që të rrisë ekspozimin e tij ndërkohe që mund të dështojë, ashtu edhe ripagesat potenciale para afatit. EAD për kartat e kreditit dhe të tjera ekspozime janë në shënimin 9.

Për të llogaritur EAD-në për një kredi në Fazën 1, Banka vlerëson ngjarjet për mospagesat e mundshme brënda 12 muajve për llogaritjen e 12mHKP. Për aktivet financiare në Fazën 2, Fazën 3 dhe POCI, ekspozimi në dështim konsiderohet për ngjarje gjatë gjithë jetës së instrumentit.

Banka përcakton EAD-të duke modeluar gamën e rezultateve të mundshme të ekspozimit në pika të ndryshme të kohës, që i korrespondojnë skenarëve të shumëfishtë. EAD më pas përcaktohet për cdo skenar ekonomik bazuar në rezultatet e modeleve të Bankës.

Humbja në dështim

Humbja në dështim përfaqëson humbjen e përlogaritur për ngjarjet e dështimit në një periudhë kohe. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësuar, nëse objekti nuk është rregjistruar më parë dhe është akoma në portofol.

Me qëllim vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit (Faza 1 dhe Faza 2), huatë grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë që janë tregues i aftësisë së debitorëve për të paguar të gjitha shumat për shkak të kushteve të kontratës (për shembull, mbi bazën e një procesi vlerësimi të kredisë ose gradimi që merr në konsideratë llojin e pasurisë, llojin e klientit, llojin e kolateralit, statusin e borxhit me vonesë dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm). Karakteristikat e zgjedhura janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të këtyre huave, duke qenë tregues i aftësisë së debitorëve për të paguar të gjitha shumat për shkak të kushteve kontraktuale të aktiveve që po vlerësohen.

Metodologjia konsiston në:

- Krijimin e një grupimi për ekspozimet me karakteristika kreditore të ngjashme (p.sh. produktet)
- Llogaritjen e një PD-je 12 mujore për cdo faze
- Llogaritja dhe pëarfërsimi i PD-ve për gjithë jetën për çdo segment me përfshirjen e rregullimit Makro.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përkufizimi i dështimit dhe përmirësimit (vazhdim)

Humbja në dështim

Llogaritja e LGD ka përbërësit e mëposhtëm:

- Probabiliteti i rikuperimit (Koeficienti i Rikuperimit)
- Norma e Humbjes pa Rikuperim

Ngjarjet e rekuperimit janë ekspozime që dalin nga statusi i dështimit (shprehin mundësinë e daljes nga statusi në Fazën 3). Pra ekspozimet që janë në transit nga statusi NPE ose FNPE në PE ose FPE në 12 muaj nga perioda e observimit identifikohen si të rikthyera në statusin e performuesve dhe nje ngjarje rekuperimi ka ndodhur. Ekspozimet konsiderohen se kanë ndaluar së qeni jo-performuese kur të gjitha kushtet në vijim plotësohen:

- Debitori nuk ka shuma me ditë vonesa më të mëdha se 90 ditë
- Një vit ka kaluar që kur masat rishtrukturoese u zgjatën
- Situata e debitorit është përmirësuar deri në ripagim të plotë, sipas origjinalit ose kur është e aplikueshme prej kushteve të modifikuara, do të behen;

Norma e Humbjes përfshin vlerësimin e koeficienteve të rikuperimit për cdo segment duke vëzhguar rikuperimet kumulative historike si përqindje e shumës së mbetur. Përsa i përket rikuperimeve, pagesat monetare historike nga ekspozimet e dështuara merren në konsideratë.

Analiza e përqëndrimit të rrezikut

Banka monitoron përqëndrimin e rrezikut të kredisë për sektor. Një analizë e rrezikut të kredisë në datën e raportimit paraqitet më poshtë:

	Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Përqëndrimi sipas sektorëve		
Shërbimet	8,504	12,045
Shitja me shumicë	3,466,236	3,780,667
Ndërtimi	1,354,518	1,118,671
Prodhimi	1,979,537	2,562,289
Pasuritë e patundshme	903,036	876,368
Të tjera	5,605,252	3,084,112
Biznese	13,317,083	11,434,152
Kredi hipotekore	10,884,524	12,458,285
Kredi konsumatore	553,155	828,716
Individë	11,437,679	13,287,001
Vlera kontabël	24,754,762	24,721,153
	Hua dhe paradhënie bankave	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Përqëndrimi sipas sektorëve		
Banka	8,097,835	6,266,933
Vlera kontabël	8,097,835	6,266,933
	Investime Financiare	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare	31,824,674	29,342,340
Vlera kontabël	31,824,674	29,342,340

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e përqëndrimit të rrezikut (vazhdim)

Cilësia e kredisë së ekspozimit maksimal të kredisë së letrave me vlerë të borxhit bazuar në klasifikimin Moody, kur është e aplikueshme, vijon si më poshtë:

Qeveria Shqiptare	Investime Financiare (letra me vlerë të borxhit)	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klasifikimi B1	31,824,674	29,342,340
	31,824,674	29,342,340

Përqëndrimi i rrezikut të kredisë

Portofoli i rrezikut të kredisë së Bankës karakterizohet nga përqëndrimet e mëposhtme të rrezikut të kredisë.

	31 dhjetor 2019	Ekspozimi në %	31 dhjetor 2018	Ekspozimi në %
Letrat me vlerë të Republikës së Shqipërisë	31,824,674	45%	29,342,340	41%
Gjendjet me Bankën e Shqipërisë	11,488,604	16%	16,148,958	23%
Rreziku total me Qeverinë Shqiptare	43,313,278	61%	45,491,298	64%
Ekspozimi më i madh me Bankat	1,958,903	3%	163,655	0%
Ekspozimi më i madh me klientët	1,206,260	2%	586,095	1%
Totali i ekspozimeve të mëdha me bankat dhe klientët	3,165,163	5%	749,750	1%
Totali i rrezikut për zërat e bilancit	46,478,441	66%	46,241,048	65%

Pala tjetër për ekspozimin më të madh me bankat më 31 dhjetor 2019 është me një Bankë e huaj, Raiffeisen Bank AG (2018: Bankë e huaj vendase, CA CIB). Pala tjetër për ekspozimin më të madh me klientët në 31 dhjetor 2019 është OSHEE SHA (2018: Kastrati sh.a).

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

	Ekspozimi Maksimal Bruto	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare dhe të ngjashme (me përjashtim të mjeteve monetare ne arkë)	8,137,551	10,627,938
Hua dhe paradhënie bankave	5,778,764	5,950,972
Investime financiare – VDATGJ	20,874,755	18,136,712
Investime financiare me kosto të amortizuar	10,949,919	11,205,628
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	24,754,762	24,721,153
Qira financiare	42,279	55,835
Debitorë të tjerë	12,879	78,728
Totali i ekspozimit për zërat e bilancit	70,550,909	70,776,966
Angazhime të patërheqshme ndaj klientëve	1,076,174	787,678
Garanci në favor të klientëve	803,165	721,997
Transaksione SPOT	530,570	185,230
Totali i angazhimeve të lidhura me kredinë	2,409,909	1,694,905
Totali i rrezikut të kredisë	72,960,818	72,471,871

Nëse aktivet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e paraqitura përfaqësojnë ekspozimin aktual të rrezikut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal që mund të lindë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve në vlera. Banka vë në dispozicion të klientëve të saj garanci të cilat mund të kërkojnë që Banka të bëjë pagesa në favor të tyre dhe të marrë angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për t'ju siguruar likuiditetin e nevojshëm. Angazhime të tilla e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme të kredisë, të cilat zbuten me të njëjtat politika dhe procese kontrolli. Çdo muaj Banka vlerëson angazhimet e lidhura me kredinë për zhvlerësim. Shumat subjekt i vlerësimeve individuale për zhvlerësim janë angazhime të pa-anullueshme dhënë klientëve të këqinj ose klientëve me kredi të riskstrukturuara.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabela e mëposhtme jep informacion për cilësinë e kreditit të aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe, për aktivet financiare, vlerat e paraqitura në tabelë paraqesin vlerën e mbetur bruto. Për angazhimet kreditore dhe kontratat e garancive financiare, vlerat në tabela paraqesin shumën e angazhimit apo të garantuar. Shpjegimi i termave: Faza 1, Faza 2 dhe Faza 3 përfshihen në Shënimin 15.

	Më 31 dhjetor 2019					Më 31 dhjetor 2018
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali	Totali
Arka dhe llogari me Banken Qëndrore						
Risk i ulët – i drejtë	13,153,086	-	-	-	13,153,086	18,251,733
Pakësuar me zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
Vlera e mbartur	13,153,086	-	-	-	13,153,086	18,251,733
Hua dhe paradhënie bankave						
Risk i ulët – i drejtë	2,427,711	-	-	-	2,427,711	429,952
Pakësuar me zhvlerësimin	-	-	-	-	-	-
Vlera e mbartur	2,427,711	-	-	-	2,427,711	429,952
Letra me vlerë						
Risk i ulët – i drejtë	31,866,277	-	-	-	31,866,277	29,386,089
Në ndjekje	-	-	-	-	-	-
Pakësuar me zhvlerësimin	(41,603)	-	-	-	(41,603)	(43,749)
Vlera e mbartur	31,824,674	-	-	-	31,824,674	29,342,340
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve						
Risk i ulët – i drejtë	19,990,995	344,220	4,009	-	20,339,224	19,275,538
Në ndjekje	128,849	959,544	75,471	-	1,163,864	1,578,446
Nenstandarte	104,524	393,354	1,369,420	-	1,867,298	1,882,233
I dyshimtë	13,061	60,217	1,377,896	-	1,451,174	2,257,790
I humbur	84,789	8,643	2,293,126	-	2,386,558	2,702,905
Pakësuar me zhvlerësimin	(274,380)	(86,690)	(2,089,986)	-	(2,451,056)	(2,970,588)
Vlera e mbartur	20,047,838	1,679,288	3,029,936	-	24,757,062	24,726,324

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumatat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2019				Më 31 dhjetor 2018
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Qira financiare					
Risk i ulët – i drejtë	42,706	-	-	-	42,706
Në ndjekje	-	-	-	-	-
Nenstandarte	-	-	-	-	-
I dyshimtë	-	-	-	-	-
I humbur	-	-	-	-	-
Pakësuar me zhvlerësimin	(427)	-	-	-	(427)
Vlera e mbartur	42,279	-	-	-	42,279
Garancite dhe angazhimet e tjera financiare					
Risk i ulët – i drejtë	803,164	-	-	-	803,164
Pakësuar me zhvlerësimin	(2,300)	-	-	-	(2,300)
Vlera e mbartur	800,864	-	-	-	800,864

Një analizë vjetërsie e kredive në vonesë por jo të zhvlerësuar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2019					Totali
	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve:						
Hua tregtare	11,751,593	148,715	635,732	810,916	1,797,726	15,144,682
Hua hipotekore	8,168,383	614,568	420,153	298,285	1,084,040	10,585,429
Hua konsumatore	1,256,156	60,906	34,725	45,927	80,293	1,478,007
Qira Financiare	42,706	-	-	-	-	42,706
Totali bruto	21,218,838	824,189	1,090,610	1,155,128	2,962,059	27,250,824
Total HKP	634,539	69,009	107,710	510,748	1,131,777	2,453,783
Neto	20,584,299	755,180	982,900	644,380	1,830,282	24,797,041

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2018					Totali
	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve:						
Hua tregtare	8,168,870	1,402,079	688,880	904,504	2,417,371	13,581,704
Hua hipotekore	9,672,010	599,750	412,420	355,388	955,837	11,995,405
Hua konsumatore	1,778,904	56,412	40,961	34,428	209,098	2,119,803
Qira Financiare	56,399	-	-	-	-	56,399
Totali bruto	19,676,183	2,058,241	1,142,261	1,294,320	3,582,306	27,753,311
Total HKP	901,812	187,689	206,726	246,859	1,433,237	2,976,323
Neto	18,774,371	1,870,552	935,535	1,047,461	2,149,069	24,776,988

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuar

Huatë e zhvlerësuar janë ato për të cilat Banka vlerëson se mund të mos jetë në gjëndje të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshëm sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve) së huasë. Banka i klasifikon huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve në kategori pa probleme dhe me probleme siç përshkruhet më lart dhe kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huatë që shfaqin evidence objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar fluksin e skontuar monetar të ardhshëm dhe duke e krahasuar me vlerën kontabël të mbetur respektive të huasë. Huatë, të cilat nuk paraqesin evidenca për t'u zhvlerësuar individualisht, vlerësohen për zhvlerësim në grup. Zhvlerësimi në grup aplikohet gjithashtu edhe për klientë të testuar individualisht por që kanë rezultuar të mos kenë nevojë për zhvlerësim individual.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Tabela më poshtë tregon huatë dhe paradhëniet neto ndaj klientëve të klasifikuara në dy grupe kryesore, të zhvlerësuar individualisht dhe në grup.

Individualisht të zhvlerësuar	Ekspozimi Neto i huave dhe paradhëniet ndaj klientëve	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Balanca bruto	5,119,921	6,516,448
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(2,089,983)	(2,182,900)
Vlera kontabël	3,029,938	4,333,548
Të zhvlerësuar në grup		
Balanca bruto	22,015,858	21,180,464
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(291,034)	(792,859)
Vlera kontabël	21,724,824	20,387,605
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhëniet për klientët	24,754,762	24,721,153

Lëvizjet e vecanta për zhvlerësimet individuale dhe në grup paraqiten të detajuara në shënimin 15.

Tabela më poshtë tregon **qiratë financiare neto** të kategorizuara brënda dy grupeve kryesore: të zhvlerësuar individualisht dhe në grup.

Individualisht të zhvlerësuar	Ekspozimi neto për qira financiare	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Balanca bruto	-	-
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	-	-
Vlera kontabël	-	-
Të zhvlerësuar në grup		
Balanca bruto	42,706	56,399
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(427)	(564)
Vlera kontabël	42,279	55,835
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhëniet për klientët	42,279	55,835

Lëvizjet për zhvlerësimin e qirasë financiare janë detajuar në shënimin 16.

Më poshtë është një analizë e balancave bruto dhe neto (nga zbritja për humbjet nga zhvlerësimi) për huatë e zhvlerësuar individualisht sipas klasifikimit të rrezikut:

31 dhjetor 2019	Hua dhe paradhënie klientëve të zhvlerësuar individualisht			
	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
Risk i ulët – i drejtë	4,009	3,611	120,401	96,405
Në ndjekje	75,471	61,922	96,697	72,718
Nenstandarte	1,369,420	826,466	2,079,368	1,444,932
I dyshimtë	1,377,896	653,284	1,404,936	980,521
I humbur	2,293,124	1,484,655	2,815,046	1,738,972
Totali	5,119,921	3,029,938	6,516,448	4,333,548

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat e saj një gjëndje huaje/letre me vlerë (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Komiteti i Çështjeve Sensitive dhe Provigjonimit (SAC) përcakton se huaja/letra me vlerë është e pa arkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacioneve për ndryshime të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimet, dhe përfitimet nga kolaterale nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Për kreditë e standardizuara me vlerë më të vogël, vendimet për fshirjen, bazohen në statusin specifik të vonësive në pagesa të produktit si edhe në veprimet ligjore të ndjekura lidhur me procedurën e zbatimit.

Banka zotëron kolateral kundrejt kredive dhe paradhënies ndaj klientëve. Banka zbaton udhëzimet e saj të brendshme mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateraleve ose të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë. Banka zotëron kolaterale kryesisht në formën e:

- Hipotekave të pasurive të paluajtshme rezidenciale ose të biznesit;
- Pengjeve mbi aktivet e biznesit në funksionim, të tilla si makineri dhe pajisje, inventare dhe llogari të arkëtueshme;
- Mjete monetare të lëna garanci dhe letra me vlerë (si Bono Thesari), etj.

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes dhe përgjithësisht përditësohen mbi baza vjetore.

Flukset e parashikuara të të ardhurave nga kolaterale, përfshirë garancitë që mbulojnë ekspozimet, janë zakonisht burimi kryesor i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nga kreditë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

- *Vlera e realizueshme e kolateraleve*, e cila përlllogaritet duke ulur vlerën e tregut të kolateraleve me një 'faktor skontimi'. Kjo merr në konsideratë karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve dhe supozon një vlerë mesatare të rikuperueshme të një kolateralit të caktuar, bazuar në eksperiencën e Bankës.
- *Koha e flukseve të parashikuara/pritura të parasë*, e cila i referohet kohës së pritshme të rikuperimit (në vite) të një lloji të caktuar kolateralit.

Kolateralit përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të riblerjeve dhe aktivitetit të huamarrjes të letrave me vlerë.

Për qëllimin e llogaritjes së zhvlerësimit individual të kredive dhe paradhënies ndaj klientëve, kolaterale që janë marrë në konsideratë për llogaritjen e zhvlerësimit janë vetëm pasuritë e paluajtshme, mjetet monetare të vendosura si kolateral dhe garancitë bankare.

Nuk ka kolaterale mbi huatë dhe paradhëniet ndaj bankave përveç rasteve të marrëveshjeve të riblerjes të anasjelltja. Për pjesën me të madhe të portofolit të kredisë vlera e drejtë e kolateralit tejkalon shumën e kredive, megjithatë, Banka normalisht e skonton vlerën e drejtë të kolateralit me të paktën 49% në mënyrë që të mbajë parasysh vështirësitë praktike dhe administrative të ekzekutimit të një kolateralit. Në këtë mënyrë Banka mbrohet nga mospagesat e mundshme nga klienti.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuar

Më poshtë jepet detajimi i vlerës së mbartur të kredive dhe paradhënies të zhvlerësuar individualisht (duke përfshirë ekspozime jashtë bilancit) sipas kategorive, së bashku me vlerën e drejtë të kolateralit të marrë nga Banka për të siguruar këto kredi:

31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Hua të zhvlerësuar	Kolaterali me marzhet reduktuese	Hua të zhvlerësuar	Kolaterali me marzhet reduktuese
Korporatë+SME	1,749,014	1,389,944	4,364,093	3,922,814
SBE	1,820,571	1,553,835	413,978	364,046
Të siguruar individualisht	1,457,000	2,170,477	1,575,491	2,720,436
Të pasiguar individualisht	93,336	-	162,888	-
Qira financiare	-	-	-	-
Garanci	-	-	35,000	3,329
Totali bruto	5,119,921	5,114,256	6,551,448	7,010,625
Total HKP	(2,089,982)	-	(2,182,900)	-
Neto	3,029,938	-	4,368,548	-

Kur Banka mban prona të marra në zotërim nën emrin e tyre, konvertimi i tyre në para është qëllimi parësor i Bankës, nëpërmjet marketing të pronave në shitje. Të ardhurat përdoren për të zvogëluar ose likuiduar vlerën kontabël të huave. Nëse nuk ka oferta të kënaqshme, Banka e ka si praktikë të mbajë aktive të vlefshme për shitje derisa të marrë një ofertë më të mirë. Në varësi të nevojave operacionale dhe përshtatshmërisë së aktivitetit për t'i përbushur ato kushte, menaxhimi mund të vendosë të përdor pronën; në këto raste bëhet një riklasifikim i pronës në aktive afatgjata materiale të Bankës. Balancat respective të aktiveve të marra në zotërim janë dhënë në shënimin 19.

Struktura e kolateraleve të huave në Faza të ndryshme janë si më poshtë:

31 dhjetor 2019	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Pronë me marz të reduktuar	24,839,620	2,651,991	4,970,566	-	32,462,177
Pengje	-	-	-	-	-
Mjete monetare	1,212,629	30,055	143,690	-	1,386,374
Totali	26,052,249	2,682,046	5,114,256	-	33,848,551

31 dhjetor 2018	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Pronë me marz të reduktuar	31,615,984	4,017,388	6,950,230	-	42,583,602
Pengje	-	-	-	-	-
Mjete monetare	1,315,217	50,531	60,395	-	1,426,143
Totali	32,931,201	4,067,919	7,010,625	-	44,009,745

Hua dhe paradhënie të ri-negociuara

Aktivitet e ristrukturimit përfshijnë marrëveshje pagesë të zgjatura, modifikime dhe shtyrje të pagesave. Në vijim të ristrukturimit, llogaria e një klienti me vonesa rivendoset në statusin normal dhe menaxhohet së bashku me llogari të tjera të ngjashme. Totali i portofolit të ristrukturimeve gjatë vitit 2019 është 37 milion Lekë (2018: 35 milion lekë).

Më poshtë janë detajuar për produkt, vlerat kontabël të huave dhe paradhënies ndaj klientëve të ristrukturuar, të netuara nga fondet e zhvlerësimit, gjatë gjithë jetës së produktit:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tregtare	161,188	373,063	2,204,957	-	2,739,208	2,409,896
Hipotekore	348,864	227,355	376,808	-	953,027	1,096,305
Konsumatore	8,145	6,690	8,599	-	23,434	28,514
Totali	518,197	607,108	2,590,364	-	3,715,669	3,534,715

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumt në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuar (vazhdim)

Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimeve. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj për të dhënë mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakort në kontratë. Risku i shlyerjes me institucione financiare dhe kundërpartinë tjetër qeveritare përfshihet brenda një sistemi limitesh për të gjitha transaksionet me këto kundërparti dhe është objekt i monitorimit të përditshëm, percaktuar dhe rregulluar sipas rregullores së Bankës Qendrore të Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankës".

b) Rreziku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është percaktuar si paafësia e mundshme e një institucioni për të përmbushur detyrimet që ka për shkak të pamjaftueshmërisë së likuiditetit ose pamundësisë për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (risku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit në aktive financiare pa ndikuar negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme çmimet, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Përçasia e Bankës për të administruar likuiditetin është të sigurojë, sa më gjatë të jetë e mundur, të ketë gjithnjë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale dhe në kushte të vështira, pa pësuar humbje të papranueshme apo dëmtuar reputacionin e saj.

Menaxhimi i procesit të likuiditetit të Bankës përfshin:

- Financim të përditshëm, të menaxhuar nga monitorimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për të siguruar përmbushjen e kërkesave. Kjo përfshin rivendosjen e fondeve në kohën që maturohen ose merren hua nga klientët;
- Mbatjen e një portofoli aktivesh likuide dhe të arkëtueshme;
- Monitorimin e raporteve të likuiditetit të bilancit ndaj kërkesave të brëndshme dhe rregullatore; dhe
- Menaxhimi i përqendrimit dhe profilizimit të borxheve të maturuara.

Përgjegjësia për administrimin e situatës së përditshme të likuiditetit mbetet nën monitorimin e Sektorit të Thesarit. Raportet e përditshme dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet funksioneve të ndryshme të Bankës mbulojnë flukset monetare të vlerësuar për ditën, javën, dhe muajin pasues që konsiderohen si periudha kyçe të menaxhimit të likuiditetit. Pikënisja e projekteve është analiza e maturitetit kontraktual të detyrimeve financiare dhe data e pritshme e mbledhjes për aktivet financiare. Menaxhimi i likuiditetit për periudhat afatshkurtra dhe afatmesme është nën përgjegjësinë e ALCO-s. ALCO analizon në baza mujore situatën e likuiditetit të Bankës dhe propozon veprimet që konsiderohen si të nevojshme.

Elementi kyç i përdorur nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide mbi detyrimet afatshkurtra dhe hendeku kumulativ deri në 3 muaj. Për këtë qëllim aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to si dhe portofoli i letrave me vlerë të vlefshme për shitje. Raportet e likuiditetit të percaktuara nga Banka janë në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë të vendosura nga Rregullorja "Mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit".

Banka përllogarit mbi baza javore dhe mujore raportet e mëposhtme: aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, huatë ndaj depozitave dhe aktivet likuide ndaj depozitave. Aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, bonot e thesarit të qeverisë Shqiptare dhe çdo depozitë afatshkurtër me bankat të cilat maturohen brenda 7 ditëve.

Detaje të raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese ka qenë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mesatarja për periudhën	61.23%	62.37%
Minimumi për periudhën	55.92%	51.32%
Maksimumi për periudhën	83.49%	70.97%

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumt në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela në vijim tregon gjëndjen e likuiditetit të Bankës monitoruar aktualisht nga drejtimi i Bankës më 31 dhjetor 2019. Janë marrë në konsideratë flukset monetare të paskontuara hyrëse/dalëse të Bankës për aktivet dhe detyrimet financiare të bilancit dhe jashtë bilancit, sipas maturiteteve kontraktuale dhe duke mos reflektuar ndonjë ripagesa të hershme apo supozime për historikun e mbajtjes. Nëse maturimi kontraktual nuk është i aplikueshëm, Banka ka përdorur gjykimin në vlerësimin e periudhës kur këto aktive dhe detyrime financiare do të maturohen.

31 dhjetor 2019	1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vjet	Totali
AKTIVE						
Mjete monetare, neto	9,802,033	-	-	-	-	9,802,033
Rezerva e detyrueshme	1,638,420	290,283	1,306,275	2,435,146	-	5,670,124
Paradhënie bankave	108,640	-	-	-	-	108,640
Investime në letra me vlerë	1,555,095	655,762	5,654,013	19,055,243	8,695,594	35,615,707
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	682,390	1,364,781	6,141,514	8,553,751	6,235,932	22,978,368
Qira Financiare	1,234	2,413	10,997	30,475	-	45,119
Aktive financiare të tjera	40,539	-	64,104	3,826	-	108,469
TOTALI	13,828,351	2,313,239	13,176,903	30,078,441	14,931,526	74,328,460
DETYRIME						
Llogari rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse/kursimi me klientët	4,617,623	696,805	3,138,110	9,366,006	2,371,698	20,190,242
Depozita nga bankat	1,240,063	35,002	-	-	-	1,275,065
Depozita me afat nga klientët	3,900,473	5,589,548	23,933,308	11,519,160	409,234	45,351,723
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	-
Detyrime financiare të tjera	8,343	236,686	-	-	-	245,029
TOTALI	9,766,502	6,558,041	27,071,418	20,885,166	2,780,932	67,062,059
HENDEKU TOTAL I ZËRAVE TË BILANCIT	4,061,849	(4,244,802)	(13,894,515)	9,193,275	12,150,594	7,266,401
Zëra jashtë bilanci (flukse monetare hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra jashtë bilanci (flukse monetare dalëse)	20,576	36,359	706,370	116,689	196,181	1,076,175
HENDEKU TOTAL I ZËRAVE JASHTË BILANCIT	(20,576)	(36,359)	(706,370)	(116,689)	(196,181)	(1,076,175)
HENDEKU TOTAL 31 dhjetor 2019	4,041,273	(4,281,161)	(14,600,885)	9,076,586	11,954,413	6,190,226
HENDEKU I AKUMULUAR 31 dhjetor 2019	4,041,273	(239,888)	(14,840,773)	(5,764,187)	6,190,226	-

Si pjesë e administrimit të rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, Banka mban aktive likuide që përfshijnë mjete monetare dhe të ngjashme me to dhe letra me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveria, të cilat mund të shiten lehtësisht për të përmbushur nevojat për likuiditet. Flukset monetare të pritshme të Bankës për disa detyrime financiare variojnë në mënyrë të konsiderueshme nga flukset monetare kontraktuale si për shëmbull llogaritë rrjedhëse të klientëve të cilat piten të jenë të qëndrueshme dhe nuk priten të tërhiqen.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shummat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(b) Rreziku i likuditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2018	1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vjet	Totali
AKTIVE						
Mjete monetare, neto	12,730,713	-	-	-	-	12,730,713
